



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:
“Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”
ofruar nga
Universiteti “EPOKA”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

PhD. Albana Tole

PhD. Ermelinda Durmishi


Janar / 2026

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
BACHELOR NË “SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE
NDËRKOMBËTARE”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Epoka”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 213, datë 25.05.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 216, datë 24.10.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 33, datë 12.03.2021
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE / 7 PAK v.a. 2022- 2023 16 PAE / 6 PAK v.a. 2023-2024 16 PAE / 6 PAK v.a. 2024-2025 Raporti në ngarkesë mësimore për vitin akademik 2024 -2025 është: 1856 orë PAE / 400 orë PAK (83% / 17%)
18	Numri i studentëve:	10 Studentë v.a. 2022-2023 11 Studentë v.a. 2023-2024 05 Studentë v.a. 2024-2025
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al
Tel:+355 (04) 222-434232

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet nga Universiteti Epoka në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale specifikisht në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi është licensuar nëpërmjet UMASH Nr. 213, datë 25.05.2012. dhe ka filluar veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2012-2013.

Në vitin 2021 i është dhënë akreditimi i fundit me një afat kohor prej 4 vitesh dhe aktualisht programi i studimit po i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm periodik të rradhës. Ky program studimi ofrohet në gjuhën angleze, për 3 vite akademike të rregullta dhe përmban 180 ECTS. Programi i studimit Bsc në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” i përket Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë dhe sidomos kërkesat e tregut të punës në Shqipëri.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)


Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **PhD. Albana Tole** dhe **PhD. Ermelinda Durmishi**. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Majlinda Demirmeli, përfaqësuese e ASCAL. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat 05 dhe 06 Maj 2025 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-434233




bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë sic është Bsc në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të politologëve të rinj.

Universiteti “EPOKA” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.12.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 145/6 Prot, datë 23.12.2025. Universiteti “EPOKA” më datë 05.01.2026, njofton nëpërmjet sistemit se nuk kanë komente mbi draft raportin, ku shprehin dakortësinë mbi draft raportin. Në këtë mënyrë draft raporti kthehet në raport final.

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-434234



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 33 datë 12.03.2021, datë janë:

1. Institucioni, të ulë ngarkesën mësimore të stafit akademik të këtij program studimi, të shprehur në orë dhe numër lëndësh.

Plotësimi nga Institucioni: Institucioni ka ndërmarrë masa konkrete për adresimin e rekomandimit lidhur me uljen e ngarkesës mësimore të stafit akademik të këtij programi studimi, si në aspektin e orëve ashtu edhe të numrit të lëndëve, i cili është në kufi me përcaktimet e Udhëzimit 29/2017. Në tërësi, GVJ vlerëson se institucioni e përmbush kryesisht rekomandimin, duke demonstruar kapacitetet institucional dhe angazhim të vazhdueshëm për përmirësim dhe përputhje me standardet e cilësisë akademike. Analiza e dokumentacionit tregon përpjekje të qëndrueshme për një rishpërndarje më të balancuar të ngarkesës, duke siguruar mbulim kryesisht nga stafi akademik me kohë të plotë dhe përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

2. Institucioni, të saktësojë në kurikulën e këtij program studimi, orët në auditor si dhe të përfshijë orë të dedikuara për seminare dhe praktikë.

Plotësimi nga Institucioni: Institucioni ka përmbushur plotësisht rekomandimin. Në Shtojcën nr. 95, si dhe në Tabelat 10.3 dhe 11, janë evidentuar qartë ndryshimet e bëra, ku specifikohen orët e zhvillimit në auditor, leksione, seminare dhe praktika, aty ku është e aplikueshme. Ndryshimet përfshijnë lëndët: PIR 111, PIR 122, PIR 130, PIR 201, PIR 203, PIR 220, PIR 212, PIR 351, PIR 333, PIR 330 dhe PIR 362.

3. Institucioni, të lehtësojë kurikulën e këtij program studimi nga lëndët e gjuhëve të huaja dhe të përfshijë në të lëndë nga fusha e teknologjisë informacionit, me qëllim formimin sa më të përgjithshëm të studentëve.

Plotësimi nga Institucioni: Institucioni ka përmbushur plotësisht rekomandimin, duke shtuar lëndën “Informacioni, Teknologjia dhe Pushteti Politik” si lëndë të detyrueshme në vitin e dytë të studimeve. Ndërkohë, gjuhët e huaja janë përcaktuar si lëndë me zgjedhje, ku studentët në semestrin I dhe II të vitit të dytë zgjedhin një nga katër gjuhë të huaja të ofruara. Gjithashtu, në vitin e parë, semestri II, është përfshirë lënda “Anglisht e Avancuar” si lëndë e detyrueshme

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Bachelor në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” është përgatitur duke u mbështetur në kërkesat e tregut aktual të punës, traditat akademike të institucionit dhe zhvillimet integruese të vendit, duke respektuar dhe promovuar vlerat dhe interesat kombëtare tek brezi i ri, në vend që të bien në kundërshtim me to. Statuti i Universitetit Epoka e përshkruan qartë vizionin dhe misionin e tij si institucion i arsimit të lartë, i cili synon të japë kontribut në përmbushjen e prioriteteve strategjike dhe objektivave zhvillimore të vendit përmes programeve të tij akademike. Sipas dokumentacionit zyrtar të institucionit, misioni i tij është të garantojë një arsimim cilësor për studentët, duke i pajisur ata jo vetëm me njohuri akademike, por edhe me vlera qytetare dhe demokratike që i shërbejnë përparimit të shoqërisë shqiptare. <i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 12</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është i harmonizuar me zhvillimet politike jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe rajonal, pasi një pjesë e mirë e lëndëve akademike trajtojnë tematika që lidhen me demokratizimin dhe proceset e integritimit evropian. Ky program zbatohet në përputhje të plotë me vizionin dhe objektivat e institucionit të arsimit të lartë, duke synuar përgatitjen akademike të studentëve në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, me ndikim të drejtpërdrejtë në rajon dhe më gjerë. Ai synon të ofrojë një arsimim cilësor përmes bashkëpunimeve me institucione ndërkombëtare të profilit akademik dhe profesional. <i>Shtojca. 1, shtojca. 12</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për	Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është ndërtuar në përputhje me rregulloret përkatëse të institucionit dhe njësisë akademike përkatëse, si dhe në bazë të planifikimit strategjik

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-434236

<p>zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>të institucionit. Qëllimi i tij është pajisja e studentëve me njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të thelluara profesionale në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Në linjë me Statutin e institucionit, ky program synon të zhvillojë njohuritë akademike të studentëve dhe t'i aftësojë ata profesionalisht në mënyrë bashkëkohore, përmes një kombinimi të metodave të mësimdhënies dhe përvojës praktike. Programi përgatit profesionistë të kualifikuar që mund të përshtaten me kërkesat e tregut të punës në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin zyrtar dhe konstatimet gjatë vizitave në institucion, ky program përfaqëson një model të suksesshëm që bashkon përvojën akademike me bashkëpunimin ndërkombëtar, duke pasur si qëllim përfundimtar përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës. <i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 13</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti Epoka ofron diploma në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për të tre ciklet e studimeve: Bachelor, Master (si Master Profesional ashtu edhe Master Shkencor), dhe Doktoraturë. Të gjitha programet zhvillohen në gjuhën angleze. Stafi akademik, i përbërë nga pedagogë vendas dhe të huaj, ka përvojën dhe aftësitë e duhura për të ofruar një arsimim të një niveli të lartë.</p> <p>Për krijimin e tij, departamenti është mbështetur në praktikat më të mira të arsimit të lartë në universitetet ndërkombëtare. Në këtë program janë përfshirë pedagogë të kualifikuar, të cilët përveçse përmbushin standardet akademike, kanë edhe përvojë në fushën e ligjërimit dhe kërkimit shkencor. Kampusi modern i universitetit është i disponueshëm për studentët, për të mbështetur procesin e të mësuarit dhe hulumtimit në nivelin Bachelor. <i>Shtojca nr. 6, shtojca nr. 76, shtojca nr. 95</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale brenda të cilit strehohet njësia bazë që ofron programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. GVJ konkludon se fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë. Kodi i programit të studimeve Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, është 63BA01312A.</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-434237

<p>sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Ky program synon të formojë studentë të nivelit Bachelor në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, të cilët të jenë të përgatitur për t'u përfshirë në institucione vendimmarrëse, organizata ndërkombëtare, organizata joqeveritare, si dhe në administratën publike dhe diplomaci. Fakulteti përkatës në Universitetin Epoka është i angazhuar të ofrojë një formim të plotë dhe bashkëkohor, në përputhje me zhvillimet më të fundit akademike dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Lëndët që përfshihen në planin mësimor trajtojnë tema të rëndësishme si administrimi publik, politikat qeveritare, marrëdhëniet ndërkombëtare, çështjet e sigurisë dhe diplomacia, me një fokus të veçantë në Europën Juglindore dhe proceset e integritimit evropian. Studentët përfitojnë nga një formim gjithëpërfshirës, që përfshin teori, praktikë dhe aftësi analitike, me synim përgatitjen për karrierë brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, bashkëpunimi ndërkombëtar është një komponent kyç i programit, duke përfshirë marrëveshje me universitete partnere dhe mundësi për shkëmbime studentore. Plani mësimor është ndërtuar në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe referencat e vendeve të BE-së.</p> <p><i>Shtojca nr. 13, shtojca nr. 20, shtojca nr. 107</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin Epoka është ndërtuar në përputhje me standardet akademike, kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet politike rajonale.</i></p> <p><i>Ai ofron formim të thelluar teorik dhe praktik, duke përgatitur studentë të aftë për t'u integruar në tregun vendas dhe ndërkombëtar.</i></p> <p><i>Mësimi në gjuhën angleze, infrastruktura moderne dhe bashkëpunimet ndërkombëtare e bëjnë programin tërheqës dhe efektiv. Programi përfaqëson një kombinim të suksesshëm të traditës akademike me vizionin evropian të zhvillimit arsimor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al
 Tel: +355 (04) 222-434238




realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në përgjithësi, nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimet me përfaqësues të ndryshëm, u vu re se institucioni i arsimit të lartë promovon një kulturë bashkëpunimi të natyrshëm mes stafit. Si një universitet me përmasa të moderuara, ndërveprimi dhe komunikimi ndërmjet aktorëve ndodh në mënyrë spontane dhe efikase. Statuti dhe Rregulloret e institucionit dhe të njësive përkatëse përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë, duke garantuar qartësi në pritshmëritë ndaj çdo aktori të përfshirë.</p> <p><i>Shtojca nr. 1</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka një sërë marrëveshesh me institucione kombëtare, publike e jopublike, si dhe profesionale ku studentët mund të ndërmarrin aftësim profesional. Këto marrëveshje shfrytëzohen edhe për të përthithur zërin e tregut të punës dhe për të mundësuar përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Gjithashtu, duke qenë se ky program ka një numër të vogël studentësh, këto marrëveshje janë mëse të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e tyre</p> <p>Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+ midis Universitetit EPOKA dhe institucioneve të arsimit të lartë në europë, në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare janë hartuar për të promovuar shkëmbimin akademik, për të nxitur mirëkuptimin ndërkulturor dhe për të rritur cilësinë e arsimit dhe kërkimit. Janë 12 Institucione me të cilat Universiteti Epoka ka lidhur marrëveshje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. University of International Studies of Rome; 2. University of Salerno; 3. Goce Delcev University, Stip, North Macedonia; 4. Catholique University of Lille, Francw; 5. Hochschule Fulda - University of Applied Sciences, Gjermani; 6. Europe University of Flensburg, Gjermani; 7. University of Belgrade, Serbi; 8. Ovidius University of Constanta, Hungari; 9. Nicolaus Copernicus University, Poloni;

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-434239

	<p>10. University of Oradea, Rumani; 11. University of Tuscia, Itali; 12. University of Tartu, Estoni;</p> <p><i>Shtojca nr. 21, shtojca nr. 26, shtojca nr. 63, shtojca nr. 95</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Institucioni paraqiti një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në RVB dhe gjatë vizitës, me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, publike dhe jo, akademike dhe profesionale me të cilat bashkepunon në nivele të ndryshme dhe ku studentët mund të marrin njohuri profesionale. Universiteti EPOKA zhvillon trajnime dhe workshope te ndrshme, me specialist të fushës, të cilët japin njohuri rreth të rejave në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në bazë dhe të marrëveshjeve Erasmus studentët kanë munnësi të shkëmbejnë eksperiencë më të mira me disa nga institucionet europiane partnere që IAL-ja ka marrëveshje. Bazuar në këto të dhëna konkludojmë që ky kriter plotësohet.</p> <p>Referuar <i>shtojcës nr. 95, tab 5</i>, janë nënshkruar rreth 30 marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale me institucione të tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm shoqërorë për arsimin e lartë.</p> <p><i>Shtojca nr. 24, shtojca nr. 25, shtojca nr. 53, shtojca nr. 68, shtojca nr. 69, shtojca nr. 74, shtojca nr. 95, shtojca nr. 102</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit ka një strategji zhvillimi e cila është bazuar në analizën, në rang departamenti, mbi ecurinë e programit ndër vite. Departamenti në bashkëpunim me njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, analizon problematikat e vërejtura mbi programin dhe ndërmer hapat përkatëse.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik departamenti del me një raport vjetor. Këto raporte shpërndahen në autoritetet përkatëse për marrjen e masave. Gjithsesi ndryshimet përpiqen të bëhen nën kufirin 20% që të mos konsiderohet riorganizim.</p> <p><i>Shtojca nr. 74</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL ka një sërë marrëveshjesh me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat, duke patur parasysh edhe numrin e vogël të studentëve, janë mëse të mjaftueshme për realizimin e komponentit praktik të programit të studimit.</i></p> <p><i>Departamenti çdo vit akademik harton një raport analitik për të marrë masat për të përmirësuar programet e studimit që</i></p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-4342310

	<i>ofron.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi është ndërtuar sipas standardeve të Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ku çdo lëndë vlerësohet me kredite përkatëse. Përmbajtja e tij fokusohet kryesisht në tematika që lidhen me proceset e integritimit evropian, të drejtën e BE-së, sistemet politike të vendeve europiane, politikat publike dhe sektorët kryesorë të veprimit të Bashkimit European. Ky program ka një kohëzgjatje normale prej 3 vitesh, i ndarë me 60 ECTS për vit dhe në fund perfundon duke mbledhur 10 ECTS. Titujt e lëndëve janë të qartë, përfaqësojnë drejt temat e trajtuara dhe janë në harmoni me qëllimet e përgjithshme të programit. Të gjitha këto elemente janë të pasqyruara në rregulloren përkatëse dhe planin mësimor të programit, në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga autoritetet arsimore përgjegjëse. <i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 5</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik	Programi përqendrohet në zhvillimin e njohurive në politologji, diplomaci dhe marrëdhënie ndërkombëtare, veçanërisht në kontekstin e Bashkimit European. Studentët e këtij programi kanë perspektiva punësimi në administratën publike qendrore, ku njohuritë mbi strukturat dhe legjislacionin e BE-së janë të domosdoshme, si dhe mundësi për të ndjekur studime të mëtejshme. Përmbajtja mësimore dhe lëndët janë në harmoni me objektivat formues të

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342311

<p>të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>programit dhe kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave të kërkuara.</p> <p>Nga të dhënat dhe vizita në institucion u vërejt se universiteti është i orientuar drejt formimit të profesionistëve të aftë për t'u përshtatur shpejt me kërkesat e tregut të punës. Në këtë drejtim, institucioni ka përfshirë edhe pedagogë të jashtëm me përvojë konkrete në fusha të lidhura me programin.</p> <p><i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 5</i></p>																														
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi përmban të gjithë elementët sipas strukturës së përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Referuar (<i>Tabelat Permbledhese [Shqip] tab nr. 9.3</i>) Veprimtaritë formuese të programit A-E janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë si dhe VKM 41, e ndryshuar, sipas peshës së krediteve për kategori, specifikisht si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="608 981 1321 1556"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi</th> <th>ECTS</th> <th>%</th> <th>Standardi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë Bazë</td> <td>36</td> <td>20%</td> <td>15-20 %</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>93</td> <td>51.6 %</td> <td>50-55 %</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore / integruese</td> <td>25</td> <td>13.8 %</td> <td>12-15 %</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale</td> <td>20</td> <td>11.1 %</td> <td>10-15 %</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar</td> <td>6</td> <td>3.3 %</td> <td>3-5 %</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 95</i></p>	Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi	A	Lëndë Bazë	36	20%	15-20 %	B	Lëndë karakterizuese	93	51.6 %	50-55 %	C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	25	13.8 %	12-15 %	D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	20	11.1 %	10-15 %	E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	6	3.3 %	3-5 %
Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi																											
A	Lëndë Bazë	36	20%	15-20 %																											
B	Lëndë karakterizuese	93	51.6 %	50-55 %																											
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	25	13.8 %	12-15 %																											
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	20	11.1 %	10-15 %																											
E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	6	3.3 %	3-5 %																											
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Studentët kanë të parashikuar në planin mësimor praktikë profesionale që është llogaritur në 5 kredite, e cila zhvillohet në vitin e tretë. Kjo lëndë është dizënuar për ti ofruar studentëve një përvojë të drejtëpërdrejtë në një ambient profesional duke u përshtatur me objektivat e këtij program studimi. Studentët kanë edhe një udhëzues për realizimin e</p>																														

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342312

	praktikës, e cila përmban të gjithë elementët e duhur për ti ardhë në ndihmë atyre. <i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 53, shtojca nr. 95</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N / A
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<p>Program i studimit mund të thuhet që ka një ngjashmëri të dukshme me disa programe të njehta që ofrohen nga institucione të arsimit të lartë kombëtare, por ashtu sic jemi shprehur edhe më sipër, kurikula e këtij program studimi është bazuar edhe në eksperiencat europiane. Kjo e bën këtë program studimi më të lehtë për tu aksesuar nga studentët që dëshirojnë të transferojnë studimet apo marrin pjesë në mobilitete. Aktualisht Programe Bachelor në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare ofrohen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bsc Shkenca Politike, Universiteti Barleti; • Bsc Shkenca Politike, Universiteti i Tiranës; • Bsc Shkenca Politike, me profile: a. Administratë Publike, b. Partitë Politike, c. Sociologji Politike, d. Gazetari, e. Studime Europiane, Universiteti European i Tiranës; • Bsc Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike", Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"; • Bsc Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare" me profile "Marrëdhënie Ndërkombëtare" dhe "Politikat dhe Legjislacioni i Bashkimit Evropian", Universiteti i Neë York-ut në Tiranë; • Bsc Shkenca Politike, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë; <p><i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 5</i></p>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra	Institucioni i ka vendosur kodin 63BA0312A , i cila është në përputhje dispozitat ligjore për këtë process. Propozimet e IAL-ve në vend janë dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe sportit, me qëllim finalizimin e listës dhe publikimit të tyre.

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342313

publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.									
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N / A								
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit Bsc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është ndërtuar sipas standardeve të ECTS dhe përqendrohet në temat e integritit evropian, diplomacisë dhe politologjisë, duke ofruar një kombinim të balancuar mes njohurive teorike dhe praktikës profesionale.</i></p> <p><i>Ai përfshin lëndë të strukturuar sipas kërkesave ligjore dhe është i përshtatshëm për punësim në institucione publike apo për vazhdimin e studimeve.</i></p> <p><i>Angazhimi i pedagogëve me përvojë praktike dhe zhvillimi i praktikës profesionale rrisin ndjeshëm përgatitjen e studentëve për tregun e punës.</i></p> <p><i>Gjithashtu, programi është ndërtuar mbi modele evropiane, duke mundësuar lehtësisht mobilitetin akademik dhe transferimin e studimeve.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (FDSHS) është njësia kryesore e cila koordinon të gjithë veprimtarinë mësimore-profesionale të shkencave juridike, shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Epoka. FDSHS është e organizuar në 3 njësi bazë të cilat janë:

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342314

legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- Departamenti i Drejtësisë;
- Qendra për Studime Europiane.

Njësia kryesore dhe njësitë bazë përbërëse të saj kanë staf akademik dhe ndihmës akademik (në sasi dhe në formim me grada e tituj) në përputhje me ligjin 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi.

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale për tri vite akademike 2022-2023; 2023-2024 dhe 2024-2025 ka në strukturën e tij këto të dhëna:

Kualifikimi i stafit në FDSHS	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	1	2	1	2	1	1
Prof.Assoc	3	2	2	1	3	2
Dr/Doc	12	9	12	8	12	4
Msc	11	5	10	5	8	4
Në total	27	18	25	16	24	11

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bsc në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, është Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, i cili i përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Kualifikimi i stafit në DSHPMN	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.Assoc	3	2	1	1	1	1
Dr/Doc	2	1	3	1	3	1
Msc	4	3	3	4	3	4
Në total	9	6	7	6	7	6

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342315

	<i>Shtojca. 20, shtojca. 95; Tabelat Permbledhese [Shqip];</i>			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga analiza e dokumentacionit GVJ vëren se njësia kryesore dhe ajo bazë përmbushin të gjitha detyrimet ligjore, nga pikpamja sasiore dhe përmbajtësore, për staf akademik me grada dhe tituj. Për tre vitet akademike të lartëpërmendura janë 4-5 staf ndihmës akademik, të gjithë me Bsc. <i>Shtojca nr. 95</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazur në RVB si dhe nga vizita në institucion, GVJ vëreu se njësia kryesore, me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë për këtë program studimi është drejtuesi i departamentit. Koordinatori kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarisë mësimore të këtij programi. Sipas GVJ, është i përshtatshëm dhe eficient. <i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 53</i>			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, përmes strukturës së tij dhe departamentit përkatës, garanton mbështetje të plotë akademike dhe organizative për programin në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Stafi akademik është i kualifikuar dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nga numri dhe shkalla e kualifikimit. Organizimi dhe drejtimi i programit është efikas dhe siguron realizimin me cilësi të veprimtarisë mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.ai

Tel:+355 (04) 222-4342316

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së vetëvlerësimit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin sigurojnë transparencë dhe informim të plotë për studentët lidhur me strukturën, përbajtjen dhe organizimin e programit.</p> <p>Këto informacione janë të aksesueshme përmes sistemit EIS, syllabuseve dhe materialeve shoqëruese, siç u konfirmua edhe gjatë takimit me një student të programit. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale funksionon nëpërmjet tre njësive bazë Departamenti i Drejtësisë, Qendra për Studime Evropiane dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, duke u mbështetur në aktet e brendshme dhe rregulloret përkatëse. Departamenti përgjegjës planifikon dhe koordinon procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 2, shtojca nr. 4, shtojca nr. 12, shtojca nr. 13, shtojca nr. 105</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Ky program studimi është konceptuar me kohëzgjatje normale 3 vite, 6 semestra dhe me 180 ECTS. Kurikula e programit të studimit përmban informacionet e nevojshme mbi lëndët dhe semestrat, gjithsesi këto informacione janë të disponueshme edhe në faqen zyrtare të universitetit. Programi është në përputhje me udhëzimet për shpërndarjen e veprimtarive formuese në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore” integruese, (praktika) dhe detyrime përmyllëse.</p> <p><i>Shtojca nr. 2, shtojca nr. 95, shtojca nr. 105</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Procedurat e pranimit janë të përshkruara në aktet rregullative të institucionit, përfshirë rregulloren e programit dhe publikohen në të gjitha kanalet informuese të institucionit. Pranimi i studentëve realizohet nga një komision përkatës, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Ministria e Arsimit si dhe në kritere shtesë të përcaktuara nga vetë institucioni. Ndërkohë, transferimi i studentëve rregullohet gjithashtu nga aktet përkatëse të institucionit dhe përshkruhet në një udhëzues specifik të përgatitur për këtë qëllim. Studentët e marrin këtë informacion sin ë formë fizike ashtu edhe online dhe janë të njohur.</p> <p><i>Shtojca nr. 2, shtojca nr. 45, shtojca nr. 47, shtojca nr. 48, shtojca nr. 50, shtojca nr. 78, shtojca nr. 105</i></p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë të dhëna të detajuara mbi njohuritë që ofrohen dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Në planin mësimor të programit janë të përfshira të gjitha komponentët sipas kërkesave të akteve nënligjore në fuqi, si: titulli i lëndës, semestri kur zhvillohet, ngarkesa orare në auditor dhe jashtë tij sipas ECTS, ngarkesa javore për leksione, seminare, ushtrime dhe praktika, raporti mes formave të mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit të njohurive si dhe numri total i krediteve.</p> <p>GVJ vlerëson se, përmbajtja e syllabus-eve të lëndëve është në përputhje me objektivat e programit të studimit, <i>por nuk janë sipas formatin të përcaktuar në VKM nr. 41/2018, i ndryshuar.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni të harmonizojë formatin e syllabus-eve me kërkesat ligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e përputhshmërisë formale dhe standardizimit të dokumentacionit akademik.</i></p> <p><i>Shtojca. 4, shtojca. 95;</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Të gjitha njësitë kryesore dhe bazë të institucionit, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, kryejnë monitorimin e procesit mësimor përmes sondazheve, vëzhgimeve dhe takimeve të rregullta me studentët, duke vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe nivelin e kënaqshmërisë së tyre.</p> <p>Periodikisht organizohen edhe takime me përfaqësues të tregut të punës për të mbledhur feedback mbi përgatitjen e të diplomuarve dhe për të identifikuar nevojat e mundshme për përmirësime në kurrikulë. Të gjitha këto të dhëna administrohen nga njësi bazë, e cila, në rast se konstaton nevojë për ndryshime, ndjek procedurat e përcaktuara në rregullore për të propozuar modifikimet përkatëse.</p> <p><i>Shtojca nr. 3, shtojca nr. 27, shtojca nr. 43, shtojca nr. 95</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se njësi përgjegjëse siguron transparencë të plotë dhe informim të vazhdueshëm për studentët mbi organizimin dhe përmbajtjen e programit, përmes sistemit EIS, syllabuseve dhe materialeve të tjera ndihmëse.</i></p> <p><i>Programi është strukturuar sipas standardeve ligjore me 180 ECTS, ku të gjitha komponentët didaktikë, si ngarkesa orare, format e mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit janë të</i></p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342318

	<p>dokumentuara në syllabuse dhe planin mësimor.</p> <p>Gjithashtu, cilësia e mësimdhënies monitorohet rregullisht përmes sondazheve dhe feedback-ut nga studentët e tregu i punës, duke mundësuar përmirësime të vazhdueshme në kurrikulë.</p> <p>GVJ vlerëson se, përmbajtja e syllabus-eve të lëndëve është në përputhje me objektivat e programit të studimit, por nuk janë sipas formatin të përcaktuar në VKM nr. 41/2018, i ndryshuar.</p> <p><u>Në këtë kuadër, rekomandohet që institucioni të harmonizojë formatin e syllabus-eve me kërkesat ligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e përputhshmërisë formale dhe standardizimit të dokumentacionit akademik.</u></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi përfshin lëndë që pajisin studentët me njohuri bashkëkohore në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, në përputhje me profilin e programit. Në kombinim me praktikën profesionale, këto lëndë kontribuojnë në zhvillimin e aftësive praktike të nevojshme për një karrierë në politologji, marrëdhënie ndërkombëtare apo administratë publike. Programi synon të përgatisë studentët për sfidat reale të tregut të punës në këto fusha. <i>Shtojca. 95</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të</p>	<p>Në funksion të qëllimit dhe objektivave formues të synuar në program, studentëve u jepen njohuri në lëndë të ndryshme në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare, përgjatë 3 viteve akademike (të ndarë në gjashtë semestra), në total, programi ka 180 ECTS.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese [Shqip], tab nr. 9.3</i></p>

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342319

nxënit.	
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit BSc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është e strukturuar në përputhje me nivelin e 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), duke siguruar formimin e duhur akademik dhe profesional për studentët. Programi synon t'i pajisë ata me njohuri teorike dhe praktike mbi zhvillimet politike, institucionet ndërkombëtare dhe marrëdhëniet globale, duke përmbushur objektivat e të nxënit të përcaktuara për këtë nivel. Gjithashtu, ai është i krahasueshëm me programe të ngjashme në universitete të njohura ndërkombëtare, duke respektuar standardet evropiane të arsimit të lartë. <i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 6</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Raporti midis përmbajtjes teorike dhe asaj praktike në programin e studimit është ndërtuar në funksion të objektivave të tij kryesore, të cilat synojnë zhvillimin e njohurive dhe aftësive praktike në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Raporti teori praktikë pasqyrohet në cdo lëndë. Përdorimi i sistemit ECTS për vlerësimin e lëndëve mundëson krahasueshmëri me programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, duke lehtësuar gjithashtu transferimin e krediteve. Institucioni promovon pjesëmarrjen e studentëve në programe mobiliteti, veçanërisht ato të mbështetura nga Bashkimi Evropian. <i>Shtojca nr. 95</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, njësia bazë dhe njësia kryesore zhvillojnë një proces vlerësimi të të dhënave të mbledhura nga analiza e vitit të kaluar, me synim përmirësimin e mëtejshëm të programit, përfshirë përditësimin e syllabuseve.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se ky proces realizohet në mënyrë të strukturuar dhe me seriozitet. Fakti që ky program studimi ofrohet në gjuhë angleze, e bën edhe më të lehtë adaptimin dhe azhormimin e literaturës. <i>Shtojca nr. 5, shtojca nr. 27, shtojca nr. 82</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi synon t'iu ofrojë studentëve aftësim praktik nëpërmjet mësimdhënies dhe lidhjes me aktorët e tregut të punës që të jenë të aftë të analizojnë fenomenet e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare me fokus në zhvillimet dhe integrimet evropiane.</p> <p>Programi synon formimin e specialistëve të rinj të aftë të punojnë ose të vijojnë specializim të mëtejshëm në fushat ku kanë interes e që lidhen me shkencat politike e marrëdhëniet</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342320

	ndërkombëtare. <i>Shtojca nr. 5</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit është strukturuar në përputhje me kërkesat e ligjore. Programi i pajis studentët me një bazë të mirë njohurish teoriko-praktike të formimit të përgjithshëm të shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Përmes formimit të gjithanshëm programi synon të krijojë mundësi për punësimin e studentëve sipas kërkesave të tregut të punës. Universiteti EPOKA demonstroi komunikim të ngushtë me institucionet e kryerjes së praktikës profesionale. <i>Shtojca nr. 39, shtojca nr. 69, shtojca nr. 95</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit BSc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është i strukturuar në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë, duke siguruar një formim të balancuar teorik e praktik për studentët.</i> <i>Ai synon zhvillimin e aftësive analitike dhe profesionale përmes përmbajtjes bashkëkohore, lidhjes me tregun e punës dhe përfshirjes në programe mobiliteti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Universiteti Epoka zhvillon bashkëpunime të shumta me partnerë, kryesisht institucione publike qendrore, ku në mënyrë të përkohshme (ad hoc) mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit me kërkesat e tregut të punës. Po kaq i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi i institucionalizuar me aktorë të tregut për të realizuar praktikat mësimore dhe për të ndërtuar ura drejt punësimin të studentëve. Për këtë qëllim, fakultetet dhe njësitë bazë organizojnë takime vjetore me partnerët e industrisë për identifikimin e nevojave profesionale dhe përmirësimin e sylabuseve që rifreskohen në fillim të çdo viti akademik. <i>Shtojca nr. 9, shtojca nr. 27, shtojca nr. 95, shtojca nr. 97</i>

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342321

<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka inkurajon përfshirjen aktive të studentëve në të gjitha nivelet vendimmarrëse, nga senati deri te njësia bazë, dhe i përfshin ata në sistemin e sigurimit të cilësisë përmes grupeve fokus dhe këshillimit të karrierës (përmes IAL). GVJ vërejtë se të dhënat e përfuara nga këto mekanizma i dërgohen njësisë akademike për përmirësim të programit, ndërsa feedback-u i drejtpërdrejtë gjatë procesit mësimor u përdor nga pedagogët për të promovuar një përmirësim gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm. Kjo qasje përputhet me praktikatat e mira ndërkombëtare sipas ESG.</p> <p><i>Shtojca nr. 97</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Ashtu sic u shprehëm edhe më sipër, rrjeti i gjerë i bashkëpunitorëve kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e përditësimin e programit të studimit. Universiteti Epoka monitoron gjithashtu rregullisht ALUMNI dhe angazhimin e tyre përmes zyrës përkatëse, që punon në bashkëpunim me njësitë administrative dhe akademike. Ata mbledhin të dhëna profesionale përmes një formulari standard, duke mundësuar ndërtimin e një baze të dhënash dhe përpunimin e statistikave mbi punësimin e të diplomuarve. <i>Shtojca nr. 68</i></p> <p><i>Në këtë kuadër, GVJ vlerëson se ekziston potencial i mëtijshëm për forcimin dhe formalizimin e mënyrës së sugjerimit e ardhura nga rrjetet profesionale dhe shoqatat përkatëse pasqyrohen në syllabus-et dhe programin mësimor.</i></p> <p><i>Në vijimësi, IAL-ja mund të ndërmarrë hapa të strukturuar për dokumentimin sistematik të këtij bashkëpunimi, duke e shndërruar atë në një praktikë të konsoliduar që do të kontribuojë në pasurimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe në forcimin e lidhjes së tyre me tregun e punës.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti Epoka ka ndërtuar një rrjet të fortë bashkëpunimesh me institucione publike dhe aktorë të tregut, duke siguruar përditësimin e sylabuseve dhe integrimin e praktikave profesionale që lidhin studentët me realitetin e punës. Përmes përfshirjes aktive të studentëve në vendimmarrje dhe sigurinë e cilësisë, universiteti shmang formalitetin dhe përdor feedback-un në kohë reale për të përmirësuar vazhdimisht programet e studimit.</i></p> <p><i>Rekomandohet krijimi dhe formalizimi i mekanizmave institucionale për përfshirjen sistematike të sugjerimeve të rrjeteve profesionale dhe alumnëve, me qëllim strukturimin e këtij feedback-u dhe rritjen e ndikimit të tij në procesin e</i></p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-4342322

	<i>përmirësimin të vazhdueshëm dhe përditësimin të kurikulës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Programi i studimit përzien metoda moderne mësimdhënieje dhe mësimnxënieje, duke favorizuar diskutime të gjalla, punë grupore dhe projekte individuale që nxisin mendimin kritik si mjet për arritjen e objektivave akademike. Studentët angazhohen në përpunimin e analizave, eseve dhe artikujve shkencorë, ndërsa pedagogët përdorin forma të ndryshme mësimore – nga projektet në grup, prezantimet dhe video ilustruese – për të rritur rezultatet e nxënësve.</p> <p>Për këtë qëllim, Universiteti Epoka shfrytëzon platformën online ESI dhe infrastrukturën institucionale për të ofruar një përvojë të larmishme arsimore dhe për të menaxhuar në mënyrë efektive materialet dhe aktivitetet mësimore.</p> <p><i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 5, shtojca nr. 11</i></p>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	<p>Strategjia e IAL fokusohet në krijimin e një mjedisi mësimor cilësor, ku theksi vendoset në adoptimin e metodave dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Staf i akademik është i përgatitur për t'u përgjigjur nevojave të studentëve. Gjatë takimeve me studentë, GVJ vuri re se ata marrin pjesë jo vetëm në aktivitetet e organizuara nga stafi akademik, por edhe në leksione të hapura me pedagogë të ftuar, si nga institucione vendase ashtu edhe ndërkombëtare. Kjo qasje forcon tërësisht përvojën e tyre akademike dhe ndihmon në përmirësimin konstant të cilësisë së procesit mësimor.</p> <p><i>Shtojca nr. 12, shtojca nr. 68, shtojca nr. 95</i></p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-4342323

<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>IAL organizon trajnime të rregullta për stafin akademik dhe, në bashkëpunim me departamentin përkatës të programit, mbështet zbatimin e metodave mësimore të avancuara me qëllim të rritjes profesionale të pedagogëve dhe motivimit për përmirësim të vazhdueshëm. Për këtë qëllim, ofrohen:</p> <p>(a) aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare ku pedagogët inkurajohen të prezantojnë punimet e tyre;</p> <p>(b) mbështetje për botimin e monografive dhe artikujve shkencorë;</p> <p>(c) pjesëmarrje në programe bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, me theks të veçantë në Erasmus;</p> <p><i>Shtojca nr. 18</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Përvoja dhe formimi ndërkombëtar i stafit akademik të departamentit ku zhvillohet programi ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë mësimore dhe sjelljen e metodave bashkëkohore në procesin e mësimdhënies. Këto përvoja ndërkombëtare u japin pedagogëve mundësi të krijojnë rrjete profesionale që favorizojnë bashkëpunimet akademike, si në kuadër të projekteve të përbashkëta, ashtu edhe përmes marrëveshjeve bilaterale me institucione evropiane. Gjithashtu, procesi i përzgjedhjes dhe vlerësimit të stafit bazohet në standarde të larta profesionale dhe përfshin leksione të hapura, ndarje të lëndëve sipas specializimit dhe ndërtimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me studentët, duke respektuar pjekurinë e tyre akademike dhe përmes bashkëpunimit me këshilltarët e klasave.</p> <p><i>Shtojca nr. 5, shtojca nr. 6, shtojca nr. 15, shtojca nr. 95, shtojca nr. 98, shtojca nr. 99</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Njësia bazë përdor një sërë instrumentesh vlerësimi të përsëritura për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Ky proces përfshin koordinatori përgjegjës, i cili zhvillon analiza të rregullta mbi personalin akademik, anketat e vlerësimit të lëndëve, rishikimin e syllabuseve, harmonizimin e ngarkesës së stafit dhe mbështetjen për staf të ri përmes trajnimeve dhe zhvillimit të kurrikulave.</p> <p>Gjithashtu, studentët plotësojnë një pyetësor të posaçëm, që jo vetëm evidenton aspektet që duhen përmirësuar, por ofron edhe rekomandime konkrete; rezultatet mbledhen në një raport vjetor që publikohet për pedagogët dhe përdoret për të</p>

	avancuar punën pedagogjike. <i>Shtojca nr. 30, shtojca nr. 31</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>Universiteti Epoka ka dy struktura kryesore për kontrollin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies: Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Njësinë përkatëse. Të dyja përdorin instrumente të ndryshme përfshirë vlerësimet semestrale nga studentët, raportet e Komisionit të Zhvillimit të Programeve, Bordit të Provimeve dhe Bordit të Vlerësimit të Performancës Akademike për të monitoruar dhe zhvilluar vazhdimisht procesin mësimor.</p> <p>Studentët kontribuojnë përmes pyetësorëve dhe dialogut me pedagogët, ndërsa rezultatet dërgohen nga departamenti te dekanati dhe rektorati; më pas, IAL organizon trajnime vjetore për pedagogët, në bazë të nevojave të identifikuara dhe sugjerimeve studentore.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 5, shtojca nr. 12, shtojca nr. 18, shtojca nr. 43, shtojca nr. 44</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit integron metoda moderne, duke nxitur diskutime aktive, punë grupore dhe projekte individuale që forcojnë mendimin kritik; përdorimi i platformës online ESI mbështet këtë qasje për një mësim të pasur dhe të strukturuar. Strategjia institucionale përqendrohet në përdorimin e teknologjive bashkëkohore dhe përfshirjen e pedagogëve të trajnuar profesionistë në aktivitete kërkimore dhe ndërkombëtare, duke siguruar një mjedis cilësor mësimor që pasqyron standarte të larta.</i></p> <p><i>Sistemi vlerësues i përhershëm përfshirë feedback-un nga studentët, analizat e performancës së stafit dhe raportet vjetore garanton një përmirësim të vazhdueshëm dhe institucionalizim të cilësisë akademike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342325

njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Pas analizave të DVV dhe RVB dhe vizitës në institucion, GVJ vuri re se mënyrat e testimit dhe vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara qartë në rregulloret e IAL, të fakultetit dhe të programit të studimit, dhe janë të aksesueshme për studentët. Kriteret e vlerësimit përshkruhen në syllabus-e të veçantë për çdo lëndë dhe mund të adaptohen nga pedagogët brenda kornizës së formave të miratuara për programet bachelor dhe master. Përveç kësaj, studentët marrin një udhëzues të plotë pas regjistrimit që përfshin informacion mbi politikat akademike, dhe lëndët vlerësohen përmes aktiviteteve si provime midis-lëndës, punë praktike, projekte dhe një prezantim përmbledhës në fund të semestrit.</p> <p><i>Shtojca nr. 2, shtojca nr. 4, shtojca nr. 5, shtojca nr. 78, shtojca nr. 95, Shtojca nr. 105</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët e programit të njoftohen që në orën e parë të kursit me syllabuset, kriteret e testimit dhe mënyrat e vlerësimit përfshirë seminarët, detyrat e kursit, testet ndërmjetëse dhe provimin përfundimtar që janë të parashikuara qartë, edhe në formë online, për të garantuar objektivitet dhe transparencë. Gjithashtu, gjatë javës së parë të vitit akademik, ata informohen nga titullari i lëndës mbi rregulloret e fakultetit dhe programit, si dhe mbi metodologjinë për vlerësimin e dijes dhe aftësive shkencore e profesionale. Ky proces vlerësimi është i vazhdueshëm, duke kombinuar angazhimin aktiv, detyrat, testimet dhe provimet, në mënyrë që të krijohet një mjedis mësimor i qartë, i strukturuar dhe cilësor qëndrueshëm. <i>Shtojca nr. 5, shtojca nr. 95</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve përcaktojnë format dhe peshën e vlerësimit për secilin komponent akademik. Testimi realizohet përmes një gamë të gjerë aktiviteteve si provimet ndërmjetëse dhe përfundimtare, detyrat e shtëpisë dhe të kursit, ushtrimet, etj, dhe mund të jetë me shkrim ose gojarisht, në varësi të natyrës së lëndës. Ky sistem i vlerësimit të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës synon të përcaktojë kompetencat e fituara nga studentët pa i penalizuar ata për forma të njëanshme të vlerësimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 5, shtojca nr. 95</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik</p>	<p>Aftësitë mësimore dhe inovative të stafit akadmeik vlerësohen vazhdimish. Pyetsorët e studentëve cdo vit, janë</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342326

<p>vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>një instrument shumë i rëndësishëm për të kuptuar mendimin e tyre rreth mësimdhënies. Aty ka një sërë pyetjesh të strukturuar mirë për të nxjerrë të dhëna të vëra për përmirsimin e mëtejshëm të metodave të mësimdhënies.</p> <p>Më pas janë edhe fokus grupet apo edhe diskutimet kolegj me koleg gjatë takimeve në departament. Universiteti Epoka nxit stafin që të aplikojë dhe trajnohet në mënyrë individuale dhe të marrë pjesë në mobilitete të ndryshme, gjithmonë në funksion të përmirimit të aftësive të tyre didaktike. <i>Shtojca nr. 31</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Institucioni ofron mundësi për përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike duke patur në qendër studentin. Studentët inkurajohen për punë të pavarur në ambientet e unirsitetit dhe në institucionet e kryerjes së praktikës për të krijuar sensin e autonomisë dhe forcuar besimin në aftësitë dhe gjykimin profesional.</p> <p>Institucioni gjithashtu i ka kushtuar rëndësi ndarjes së lëndëve që të ketë përputhje me fushën kërkimore të stafit akademik, me qëllim që informacioni të transmetohet tek studentët në formën e duhur.</p> <p><i>Shtojca nr. 5, shtojca nr. 15, shtojca nr. 6, shtojca nr. 95, shtojca nr. 98, shtojca nr. 99</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi ofron një sistem vlerësimi të qartë, objektiv dhe gjithëpërfshirës, bazuar në rregulloret e IAL, fakultetit dhe programit të cilat studentët i njoftohen që në orën e parë të lëndës dhe janë të aksesueshme edhe online.</i></p> <p><i>Metodologjia përfshin aktivitete të ndryshme pedagogjike si seminare, detyra kursi, teste ndërmjetëse apo provime përfundimtare, duke siguruar një proces të vazhdueshëm vlerësimi që përcakton kompetencat reale të studentëve. Syllabus-e të hollësishme dhe udhëzuesit akademikë plotësojnë këtë kornizë, duke garantuar transparencë, mirëkuptim të pritshmeve akademike dhe një mjedis mësimesor të strukturuar dhe cilësor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342327

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Analiza nga DVV, RVB dhe vizita në institucion tregojnë se vlerësimi i aftësive akademike të studentëve bazohet në monitorim të vazhdueshëm përgjatë gjithë semestrit, duke kombinuar pjesëmarrjen, detyrat e kursit, testin ndërmjetës dhe provimin përfundimtar. Departamenti përcakton një strukturë të qartë me pesha specifike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10–20 % për pjesëmarrjen; - 10–20 % për detyrat; - 30 % për testin ndërmjetës (në javën e 8); - 30 % për provimin përfundimtar (në javën e 15–16); <p>Ky sistem lejon pedagogët të monitorojnë përparimin e studentëve gjatë gjithë semestrit dhe t'u ofrojë atyre mundësinë për të grumbulluar pikë në mënyrë graduale, duke u mundësuar rregullime strategjike që rrisin shanset për sukses. <i>Shtojca nr. 4</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Provimet mund të zhvillohen në format të printuar ose elektronik, falë sistemit të avancuar online që ofron informacion të aksesueshëm për studentët si notat dhe frekuentimi, duke garantuar transparencë dhe parandalim të abuzimeve. Të gjitha punimet e studentëve (ese, artikuj, etj.) kontrollohen për plagjiaturë me Turnitin, me një kufi maksimal prej 20%, ndërsa provimet kryhen në mënyrë anonime, ku studentët identifikohen vetëm me numrin unik të ID-së. Për të siguruar rregull, ambientet e provimit janë të mbikëqyrura nga kamera sigurie dhe personale profesionale mbikëqyrës. <i>Shtojca nr. 32, shtojca nr. 35, shtojca nr. 89</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar zhvillohet në përputhje të rreptë me rregulloret e institucionit, njësisë bazë dhe syllabuset e çdo lënde, duke përfshirë të gjitha komponentët e testimit. Nota përfundimtare përgatitet nga përqindjet e përcaktuara në rubrikën e syllabus-it të cilat prezantohen nga pedagogët në orën e parë të lëndës dhe bazohet në kombinimin e aktiviteteve ndërmjetëse dhe përfundimtare.</p>

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342328

	<p>Bordi i Provimeve mbikëqyr mbarëvajtjen e procesit vlerësues gjatë vitit akademik dhe përmes raporteve të detajuara ofron sugjerime për përmirësime të mëtejshme, duke siguruar një cilësi të qëndrueshme në vlerësim.</p> <p><i>Shtojca nr. 2, shtojca nr. 32, shtojca nr. 36, shtojca nr. 37</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pedagogët ofrojnë komente të hollësishme për secilën komponentë të vlerësimit të studentit, dhe çdo vlerësim shoqërohet me feedback individual, të dërguar përmes email-it ose dhënë direkt studentit, në mënyrë që të bëhen të kuptueshme arsyet e vlerësimit. Një ekspert i emëruar nga Dekanati, përgjegjës për dy semestre, vlerëson provimet për të verifikuar nëse ato janë në përputhje me kërkesat e lëndës dhe nëse feedback-u i ofruar nga pedagogu ka qenë i plotë dhe efektiv për studentët në mënyrë të gjithëpërfshirëshme.</p> <p><i>Shtojca nr. 32, shtojca nr. 36, shtojca nr. 37</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>IAL përfshin në aktet rregullatore të brendshme dispozita të qarta për shkeljet disiplinore, si kopjimi dhe format e tjera të mashtrimit, të cilat shqyrtohen nga komisioni i përhershëm disiplinor. Të gjitha punimet e studentëve kontrollohen për plagjiaturë me sistemin Turnitin, i cili shpjegohet në detaje nga pedagogët për të ndihmuar studentët të kuptojnë se çfarë përbën plagjiaturë dhe si të bëjnë citime korrekte.</p> <p>Po ashtu, “Udhëzuesi për Provimet” përcakton masat që sigurojnë një proces provimi të drejtë dhe në përputhje me rregulloren e universitetit, dhe bashkëpunimi me specialistin e IT-së krijon një platformë ku studentët mund të dorëzojnë lehtësisht detyrat e tyre. <i>Shtojca nr. 32, shtojca nr. 76, shtojca nr. 88</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Provimet zhvillohen në mënyrë anonime, me ID të gjeneruar rastësisht nga zyra IT gjatë semestrit, duke garantuar paanshmëri. Format i vlerësimit përshtatet me qëllimet e lëndës dhe vlerëson aftësitë analitike, prezantuese, sintetizuese dhe mendimin kritik të studentëve përmes një procesi testimesh të vazhdueshëm që reflekton kompetencat e tyre reale. Rregullorja përcakton edhe afatet për dorëzimin e notave, të specifikuar në kalendarin akademik dhe të publikuar online, ndërsa pas përfundimit të provimeve pedagogët dorëzojnë dosjen e plotë (fletë provimi, përgjigje, kopje të provimit dhe dy kopje të notave) pranë koordinatori të departamentit brenda 10 ditëve. <i>Shtojca nr. 32, shtojca nr. 76, shtojca nr. 88</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni</p>	<p>Studentët njoftohen për notën përpara dorëzimit në sekretari</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342329

<p>garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>dhe kanë mundësinë të takojnë pedagogun për të kërkuar sqarime mbi vlerësimin. Nëse mbeten të paqartë, kanë të drejtën të ankohen brenda pesë ditëve pas marrjes së notës; pedagogu rivlerëson provimin dhe, nëse studentit nuk i bindet rezultati, mund të drejtohet pranë dekanatit për të ngritur një komision të posaçëm vlerësues. Kjo procedurë ankimi zbatohet në të gjitha nivelet akademike dhe administrative, duke garantuar drejtësi dhe transparencë për ndërhyrje të mundshme në vlerësim. <i>Shtojca nr. 40, shtojca nr. 78</i></p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studentët mund të ankohen fillimisht te pedagogu i lëndës, e nëse ky nuk e ndryshon vendimin, çështja kalon te koordinatori i departamentit dhe në fund shqyrtohet nga një komision i formuar nga dekanati. Të gjitha këto procedura janë të përshkruara në Udhëzuesin e Studentit, duke siguruar që çdo hap të jetë i qartë dhe i ndjekshëm.</p> <p>GVJ vlerëson se ky proces është transparent dhe i dokumentuar si nga studenti, ashtu edhe nga Zyra e Regjistrimit, e cila ruan dhe arkivon dëshmitë përkatëse.</p> <p><i>Shtojca nr. 2, shtojca nr. 78</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përputhje me rregulloret e institucionit dhe syllabuset përkatëse, vlerësimi i studentëve bazohet në një sistem të integruar që përfshin pjesëmarrjen, detyrat e kursit, testin ndërmjetës dhe provimin përfundimtar, duke siguruar një pasqyrë të plotë të kompetencave të tyre.</i></p> <p><i>Procedurat e provimit janë të strukturuar për të garantuar transparencë dhe drejtësi, duke përfshirë përdorimin e sistemit Turnitin për kontrollin e plagjiaturës dhe zhvillimin e provimeve në mënyrë anonime, mbikëqyrur nga kamera sigurie dhe personel mbikëqyrës.</i></p> <p><i>Në rast të mosdakordësisë me vlerësimin, studentët kanë të drejtë të ankohen fillimisht te pedagogu i lëndës dhe, nëse është e nevojshme, çështja mund të kalojë te koordinatoret e departamentit dhe komisionet përkatëse për shqyrtim të mëtejshëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342330

e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit është në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (AQF), duke siguruar zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave përkatëse për secilin nivel akademik. Metodatat e mësimdhënies dhe vlerësimit, të tilla si leksionet, seminarët, detyrat e kursit dhe projektet, janë të strukturuar për të mbështetur zhvillimin e aftësive kritike dhe analitike të studentëve. Profili akademik i pedagogëve dhe bashkëpunimi i tyre në aktivitete shkencore kontribuojnë në pasurimin e përmbajtjes së lëndëve dhe në zhvillimin e një mjedisi mësimor cilësor. <i>Shtojca. 4, shtojca. 5, shtojca. 68, shtojca nr. 95</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit është i strukturuar për të integruar njohuritë teorike me praktikën profesionale, duke përfshirë leksione, seminare dhe projekte që zhvillojnë aftësitë kritike të studentëve. Metodatat e mësimdhënies përfshijnë përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe përfshirjen e gjuhëve të huaja për të pasuruar përvojën e studentëve. Stafi akademik angazhohet në aktivitete shkencore dhe bashkëpunime ndërkombëtare, duke siguruar që njohuritë e fituara të pasqyrohen në programin didaktik dhe të jenë në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 5</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Stafi akademik prezanton për studentët syllabuset, i cili shpjegon objektivat mësimore dhe shpjegon të gjitha njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studenti gjatë vitit akademik. Në takimin me studentët, GVJ vërejtë se kjo analizë e njohurive që duhet të përfitohen, por edhe asaj që mbetet ende për t'u bërë, ndihmon studentët për t'i adresuar këto objektiva. Kjo praktikë u konfirmua edhe në takimin me pedagogët, të cilët theksuan se kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime ofrohen sugjerimet për përmirësimin e punës. <i>Shtojca nr. 5, shtojca. 32, shtojca nr. 36, shtojca nr. 37</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë	Programi i studimit ndërthuret në mënyrë strategjike me dy qasje thelbësore – teorike dhe praktike – për të siguruar zhvillimin e kompetencave të programeve akademike.

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342331

<p>studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Studentët përfitojnë nga leksione, materiale shtesë dhe projekte të strukturuar që nxisin trajnim të aftësive profesionale dhe të mendimit kritik, sipas modelit të “learning-by-doing” i mbështetur nga teoria dhe praktika në terren.</p> <p>Për më tepër, aktivizimi i diskutimeve në grup, prezentimeve dhe mobiliteteve ndërkombëtare, si për pedagogët, ashtu edhe për studentët, rrit ndikimin e njohurive në realitete profesionale dhe përgatit banorë globalisht konkurrues në tregun e punës.</p> <p><i>Shtojca nr. 5, shtojca nr. 24, shtojca nr. 26, shtojca nr. 76</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Pedagogët e departamentit zhvillojnë rregullisht orë të hapura dhe seminare ku ftojnë ekspertë të jashtëm, dhe inkurajojnë studentët të përfshihen aktivisht duke prezentuar punime individuale ose në bashkëpunim, brenda ose jashtë kornizës së programit. Ky format nxit transmetimin e përvojës dhe metodat kërkimore bashkëkohore, si dhe forcon bashkëpunimin akademik dhe ndërtimin e rrjeteve ndërkombëtare, përmes pjesëmarrjes në aktivitetet akademike të EPOKA-s dhe të institucioneve partnere. Kjo qasje jo vetëm pasuron përmbajtjen didaktike, por gjithashtu forcon aftësitë komunikuese, kërkimore dhe prezantuese të studentëve në një mjedis mësimor ndërveprues dhe mbështetës. <i>Shtojca nr. 6, shtojca nr. 67, shtojca nr. 95</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është i qartë në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, duke integruar mësim modern teorik e praktik (leksione, seminare, detyra, projekte) për zhvillimin e aftësive kritike dhe analitike.</i></p> <p><i>Stafi me përvojë ndërkombëtare dhe angazhime kërkimore përforcon përmbajtjen akademike duke sjellë praktika bashkëkohore dhe lidhje me tregun e punës, mbështetur nga teknologjia dhe gjuhët e huaja.</i></p> <p><i>Përmes analizës së syllabusit, diskutimeve interaktive dhe takimeve të vazhdueshme për feedback, studenti është i</i></p>

	<i>përfshirë aktivisht në përcaktimin e objektivave dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë arsimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Programi i studimit përcakton që studentët të përmbushin të gjitha detyrimet për çdo modul para se të fillojnë punimin e mikro-tezës apo provimin e përgjithshëm. Për të punuar një tmikrotezë, studenti duhet të ketë një mesatare mbi 3.00 deri në 4.00. cdo student me mesataren e 3 viteve nën 3.00, duhet ti nënshtrohet provimit përmbyllës. Ky informacion është i aksesueshëm online dhe bëhet në konsultim të ngushtë me pedagogët, të cilët ofrojnë mbështetje të strukturuar për përgatitjen e temës së diplomës ose provimit përfundimtar. Kjo qasje siguron një lidhje të ngushtë mes mësimdhënies dhe kërkesave të diplomimit, duke ndihmuar studentët të përgatiten në mënyrë të efektshme për fazën përfundimtare të studimeve të tyre. <i>Shtojca nr. 105</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve Rregulloren e Programit të Studimit Bsc “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, informacione në internet si dhe përmes komunikimit me këshilluesin e klasës. Pedagogët mbikëqyrës udhëzojnë studentët në hartimin e mikro-tezës, duke i orientuar ata në zhvillimin e argumenteve dhe përdorimin e burimeve të nevojshme. Ata ofrojnë informacion të detajuar mbi detyrimet akademike dhe financiare, duke përfshirë afatet dhe procedurat përkatëse. Ky mbështetje e vazhdueshme siguron që studentët të jenë të informuar dhe të përgatitur për përmbushjen e kërkesave përfundimtare të programit. <i>Shtojca nr. 2</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve	Në vitin e tretë, studentët kanë një këshillues studentësh, i cili është edhe përgjegjës për provimin gjithëpërfshirës. Ai i informon studentët rreth lëndëve më të rëndësishme të kurikulës, duke ndarë me to rreth 200 pyetje, të përgatitura nga secili pedagog. Studentët kanë të gjithë informacionin e

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342333

<p>akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>duhur përpara se të futen në provim. <i>Shtojca nr. 2</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët kanë mundësinë të zgjedhin udhëheqësin e mikro-tezës nga stafi akademik i programit, duke u bazuar në përputhshmërinë e fushës së ekspertizës së pedagogut me temën e propozuar.</p> <p>Pas përcaktimit të udhëheqësit, ata bashkëpunojnë për të kristalizuar dhe zhvilluar më tej temën, duke përcaktuar metodologjinë, analizuar rezultatet dhe hartuar konkluzionet. Ky proces përfshin dorëzimin e draft-eve për shqyrtim, ku udhëheqësi ofron feedback dhe miraton punën përpara dorëzimit përfundimtar të tezës.</p> <p><i>Shtojca nr. 4</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Udhëheqësit e tezës, sic theksuam edhe me lart, staf i brendshëm i departamentit, ofrojnë mbështetje të plotë studentëve gjatë gjithë procesit të hartimit të mikro-tezës, duke i udhëzuar ata për strukturën, argumentimin dhe burimet e nevojshme. Ata sigurojnë akses në materialet akademike të brendshme dhe, kur është e nevojshme, mundësojnë lidhje me ekspertë të jashtëm për asistencë shtesë. Kjo mbështetje e shumëanshme ndihmon studentët të përmbushin me sukses kërkesat e programit dhe të arrijnë standardet e kërkuara.</p> <p><i>Shtojca. 76, shtojca. 85, shtojca nr.. 95</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Punimi i diplomës vlerësohet nga një komision i ngritur nga Dekanati, i cili merr parasysh cilësinë e punimit dhe mbrojtjen përfundimtare. Studenti vlerësohet me notë, dhe komisioni ofron feedback me shkrim mbi vlerësimin e bërë. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i 50%.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve,</p>	<p>Në përfundim të suksesshëm të programit të studimit, studentët pajisen me diplomën dhe me Suplementin e Diplomës, të cilat janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe regjistrohen në Zyrën e Regjistrimit të Institucionit.</p> <p>Këto dokumente janë të standardizuara dhe përmbajnë informacion të detajuar mbi përmbajtjen dhe rezultatet e</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342334

studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	studimeve. Pajisja me këto dokumente bëhet në një ceremoni të veçantë, pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve akademike dhe financiare nga ana e studentit. <i>Shtojca. 38, shtojca. 39</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të studentëve, duke mbajtur regjistrin themeltar në format fizik dhe elektronik, dhe ruajtjen e dosjeve personale të studentëve pas diplomimit në arkivin qendror të universitetit. Ajo siguron që informacionet mbi kreditet e akumuluar dhe ecurinë akademike të studentëve të jenë të përditësuara dhe të disponueshme për autoritetet përkatëse. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore respekton rregullat për privatësinë dhe sigurinë e të dhënave, duke siguruar ruajtjen e informacionit në përputhje me normat në fuqi dhe rregulloren e arkivit.			
Konkluzione	<p><i>Studentët duhet të përmbushin të gjitha detyrimet për çdo modul dhe të kenë një mesatare mbi 3.00 për të nisur punimin e mikro-tezës. Nëse mesatarja është nën 3.00, ata duhet të kalojnë provimin përmbyllës.</i></p> <p><i>Punimet e diplomës vlerësohen nga një komision i ngritur nga Dekanati, i cili jep feedback me shkrim mbi vlerësimin e bërë, dhe si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i 50%.</i></p> <p><i>Në përfundim të suksesshëm të programit, studentët pajisen me diplomën e Bachelorit dhe me Suplementin e Diplomës, të cilat janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe regjistrohen në Zyrën e Rregjistrimit të Institucionit.</i></p> <p><i>Këto dokumente janë të standardizuara dhe përmbajnë informacion të detajuar mbi përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342335

Standardi IV.1
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																														
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në lidhje me rekrutimin e stafit, procedurat janë të mirëpërcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Universitetit dhe janë në përputhje të plotë me bazën ligjore në fuqi për punësimin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, në përputhje me legjislacionin përkatës, përfshirë Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Kjo është evidentuar edhe nga vizita në Institucion. Programi i studimit disponon personel akademik të angazhuar nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, icili ka një eksperiencë disavjeçare në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, fakt që vërtetohet edhe nga botimet shkencore dhe pjesëmarrja në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërkohë, në lidhje me titullarët e lëndëve ose moduleve dhe udhëheqësit e veprimtarisë kërkimore-shkencore, të cilët sipas akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi duhet të jenë të kategorisë “Profesor”, konstatohet se programi paraqet mangësi.</p> <p><i>Pjesa më e madhe e titullarëve të lëndëve janë aktualisht të kategorisë “Lektor” me gradë shkencore “Doktor”. Gjithashtu, për disa lëndë, si p.sh. gjuhët e huaja, ka raste ku titullari i lëndës është i kategorisë “Asistent Lektor” me gradë “Master Shkencor (MSc)”.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për të mundur si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë “Profesor”, sipas pika 3 neni 59, Ligjit Nr. 80/2015.</i></p> <p>Të dhënat e stafit mësimdhënës në këtë program studimi për katër vite akademike janë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="526 1422 1316 1792"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">21 - 22</th> <th colspan="2">22-23</th> <th colspan="2">23-24</th> <th colspan="2">24 - 25</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>8</td> <td>2</td> <td>8</td> <td>2</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>11</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>5</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>14</td> <td>5</td> <td>15</td> <td>7</td> <td>16</td> <td>6</td> <td>16</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/grada	21 - 22		22-23		23-24		24 - 25		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	-	-	1	-	2	-	1	-	Prof.As.Dr	2	2	3	2	1	1	1	1	Dr/PhD	8	2	8	2	8	1	11	1	Msc	4	1	3	3	5	4	3	4	Në total	14	5	15	7	16	6	16	6
Tituj/grada	21 - 22		22-23		23-24		24 - 25																																																								
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																							
Prof.Dr	-	-	1	-	2	-	1	-																																																							
Prof.As.Dr	2	2	3	2	1	1	1	1																																																							
Dr/PhD	8	2	8	2	8	1	11	1																																																							
Msc	4	1	3	3	5	4	3	4																																																							
Në total	14	5	15	7	16	6	16	6																																																							
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv</p>	<p>Ngarkesa mësimore e stafit akademik është e përcaktuar në Direktivën e Universitetit EPOKA “Mbi ngarkesën mësimore”, e cila</p>																																																														

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342336

duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

specifikon ngarkesën javore të lejuar për personelin akademik. Megjithatë, nga analiza e kryer në përputhje me Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", rezulton tejkalim i ngarkesës vjetore të lejuar për kategoritë profesor, lektor dhe asistent lektor, 4 nga 21 staf akademik i angazhuar.

- A. I. – 448 ore
- D. H. – 448 ore
- A. C. – 512 ore
- H. M. – 432 ore

Gjithashtu, rezulton se stafi akademik me kohë të plotë i angazhuar në këtë program studimi ka një numër më të lartë lëndësh semestrale në disa raste sesa parashikon Udhëzimi nr. 29/2018, siç paraqitet më poshtë:

- R. Sh. – 7 lëndë semestrale
- A. I. – 7 lëndë semestrale
- J. V. – 7 lëndë semestrale
- D. H. – 9 lëndë semestrale
- G. S. – 7 lëndë semestrale
- H. M. – 7 lëndë semestrale

GVJ rekomandon një shpërndarje më të mirë të ngarkesës mësimore në stafin akademik, në mënyrë që të vijojë procesi i përmirësimeve të ndërmarra deri më tani dhe të sigurohet zbatimi i plotë i akteve nënligjore në fuqi.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga IAL raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK në tre vite akademike është si më poshtë:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE / PAK (%)
22 - 23	2176 orësh	1680 orësh	496 orësh	78 % / 22 %
23 - 24	2160 orësh	1648 orësh	512 orësh	76.2 % / 23.8 %
24 - 25	2256 orësh	1856 orësh	400 orësh	83 % / 17 %

Nga sa më sipër rezulton se për 2 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.

Shtojca nr. 4, Shtojca nr. 5 (1-7), Shtojca nr. 6, Shtojca nr. 84, Tabela përmbledhëse

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342337

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në lidhje me qëndrueshmërinë e stafit akademik, gjatë vizitës në institucion, si edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet një nivel i mirë qëndrueshmërie i tij, i mbështetur në rregulla të qarta dhe kritere të mirëpërcaktuara për punësimin dhe vazhdimësinë në punë. Kontratat e punës janë gjithëpërfshirëse dhe shoqërohen me pagesën e detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore, në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Nga evidenca e stafit ndër vite vihet re një qëndrueshmëri e përgjithshme e personelit akademik. Edhe pse gjatë katër viteve të fundit është konstatuar një lëvizje e lehtë, kjo lidhet kryesisht me dinamikat e tregut të punës dhe nuk ka ndikuar në vijimësinë e mësimdhënies dhe të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 16, Tabela përmbledhese</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Takimi i GVJ me stafin akademik konfirmoi se ata janë titullarë të moduleve, lëndëve në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre dhe përmbajtjen e programit të studimit, dhe të rekrutuar sipas rregulloreve të Univeritetit dhe Statutit. Mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga institucioni, shpallet konkurs i hapur për vendet e lira të punës për personel akademik dhe kryhet publikimi në faqen online të Univeritetit, rrjete sociale zyrtare të institucionit dhe në portale të tjera të punësimit.</p> <p>Nga takimi i GVJ me drejtorinë e burimeve njerëzore në universitet na u vunë në dispozicion CV-akademike dhe kontratat e punës, si dhe procedurat standarde të rekrutimi dhe vlerësimit të stafit akademik. GVJ gjykon se Universiteti EPOKA mbështetet në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit, procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik efektiv dhe jo efektiv në përputhje me aktet ligjore.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, Shtojca nr. 7, Shtojca nr. 15, Shtojca nr. 16, Shtojca nr. 29</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor rezulton se për programin e studimit është parashikuar vetëm një lëndë që përfshin komponent laboratorik, konkretisht lënda “Zhvillimi i aftësive lexuese dhe shkruese”, e cila zhvillohet me rreth 32 orë leksion dhe 32 orë laborator. Lëndët e tjera të syllabuseve të programit “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” zhvillohen kryesisht në formën e leksioneve dhe seminareve, ndërsa disa prej tyre përfshijnë edhe komponentë praktikë.</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342338

<p>realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Stafi i angazhuar në realizimin e orëve laboratorike për lëndën përkatëse është i kategorisë asistent lektor, me kualifikim Master i Shkencave (M.A.)</p> <p><i>Shtojca nr. 4</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Univeristetin EPOKA e takimit me drejtorinë juridike dhe burimeve njerëzore konstatoi se statistikak mblidhen dhe përpunohen periodikisht çdo vit akademik. DBNJ përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit dhe i ruan ne dosjet individuale të të gjithë personelit.</p> <p>Institucioni i raporton në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në formë elektronike dhe në letër këto të dhëna që përfshijnë statistikak mbi personelin akademik efektiv dhe jo-efektiv, ndihmës-akademik me kohë të plotë e të pjesshme, personelin akademik sipas titujve dhe gradave, statistika mbi ngarkesën mësimore të personelit akademik, etj.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, Shtojca nr. 7</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e</p>	<p>Universiteti EPOKA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë dhe institucione të tjera publike e private, të cilat janë drejtpërdrejt në funksion të zbatimit dhe zhvillimit të Programit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Këto marrëveshje synojnë mbështetjen e procesit mësimor, praktikës profesionale, udhëheqjes së punimeve të diplomës dhe përfshirjes së studentëve në veprimtari profesionale</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342339

<p>kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>të lidhura me profilin e programit të studimit. Nënder institucionet partnere përfshihen, ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrjeti Akademik Shqiptar; • Prezenca e Zyrës së OSBE-së në Tiranë; • Parlamenti i Republikës së Shqipërisë; • Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale; • Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, etj. <p>Këto bashkëpunime garantojnë vënien në dispozicion të personelit të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Marrëveshjet përkatëse janë të dokumentuara dhe të pasqyruara në mënyrë të detajuar në Tabelën 5 të Shtojcës nr. 95.</p> <p><i>Shtojca nr. 26, Shtojca nr. 69, Shtojca nr. 70</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Aktet rregullatore të Institucionit përcaktojnë procesin e zhvillimit të praktikës mësimore për studentët e programit bachelor, ku personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përbushjen e detyrimeve. Për këtë program studimi praktika realizohet 80 orë semestrale, ku studenti duhet të jetë çdo ditë në institucionin e përcaktuar për 5 orë në ditë. Një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësimin të studentëve për të realizuar, jo vetëm aplikimin e njohurive praktike, por edhe zhvillimin e mendimit kritik si dhe të aftësive kërkimore të tyre. Komunikimi efektiv ndërmjet studentëve dhe stafit mbikëqyrës është thelbësor. Stafit mbikëqyrës merr pjesë aktive në procesin e vlerësimit të praktikës së studentit. Vlerësimi përfshin performancën e studentit gjatë praktikës, ofrimin e komenteve dhe kontributin në vlerësimin përfundimtar të këtij procesi.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, Shtojca nr. 70</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti EPOKA disponon personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor për realizimin e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare" dhe fusha e mesimdhënies perputhet me programin e studimit.</i></p> <p><i>Procedurat e rekrutimit janë të rregullta, transparente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i></p>

	<p>Në lidhje me ngarkesën mësimore, evidentohet disa raste te tejkalimit të kufijve të lejuar sipas Udhëzimit nr. 29/2018, në lidhje me ngarkesën mësimore dhe nurmin e lëndëve për semester / vjetore.</p> <p>GVJ rekomandon një shpërndarje më të mirë të ngarkesës mësimore në stafin akademik, në mënyrë që të vijojë procesi i përmirësimeve të ndërmarra deri më tani dhe të sigurohet zbatimi i plotë i akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Sa i përket qëndrueshmërisë së stafit, konstatohet stabilitet i mirë ndër vite, me kontrata të rregullta pune dhe sigurime të paguara sipas ligjit.</p> <p>GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë “Profesor”, sipas pika 3 neni 59, Ligjit Nr. 80/2015.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ vizitoi mjediset e Univeritetit EPOKA dhe vlerëson se ka mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit në auditore në përputhje me numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Institucioni plotëson normativën e sipërfaqes (2.5 m ² për student), plotëson normativat e ndriçimit natyral, siguron ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën dhe përbush kërkesat për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit sipas percaktimeve ligjore. Univeriteti EPOKA disponon ambientet e detyrueshme sipas percaktimeve të bazes ligjore si auditorë mesimi, ambiente për laboratore, ambiente për personel akademik, administrative, biblioteke, ambiente teknike, oborr, ambiente të gjelberuara etj. <i>Vizita në Institucion, Shtojca nr. 76, Shtojca nr. 77</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe bisedës me stafin vlerëson se mjediset mësimore si sallat e leksioneve dhe seminareve, laboratorët, bibliotekat dhe mjediset e tjera plotësojnë të gjitha kushtet për mësimdhënie dhe punë në funksion të programit të

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342341

<p>mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>studimit. Auditoret janë të pajisura me videoprojektor, rrjete wireless dhe me mjetet e nevojshme të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Ato lehtësojnë aplikimin e metodave interaktive në auditor, ndërveprimin me studentët duke lehtësuar zbatimin e programit.</p> <p><i>Vizita në Institucion, Shtojca nr. 88</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Instiucion vlerëson se Universiteti EPOKA disponon laboratorë dhe mjedise te tjera infrastrukturore të përshtatshme për përmbushjen e kërkesave të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëare”, si dhe për zhvillimin dhe kërkimin individual të studentëve në funksion të zbatimit të kurrikulës.</p> <p>Ambientet e Univeristeti EPOKA sigurojnë/mbështesin zhvillimin e aktivitete ekstra-kurrikulare si leksione të hapura, workshope, seminare ku prezantohen punime të realizuara nga studentët në projektet e kurseve duke përmbushur objektivat formues të programit të studimit në tërësi. <i>Vizita ne Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, vlerëson se Universiteti EPOKA disponon laboratorë të teknologjisë së informacionit që shërbejnë në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit në përgjithësi, për qëllime didaktike, formuese dhe ndihmëse në procesin mësimor.</p> <p><i>Vizita ne Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara gjatë vizitës në institucion, shqyrtimin e dokumentacionit shoqërues (Shtojcat nr. 76, 77, 88) dhe bisedat me stafin akademik dhe administrativ, vlerëson se Universiteti EPOKA disponon mjedise të mjaftueshme, funksionale dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”.</i></p> <p><i>Institucioni përmbush plotësisht normativat ligjore lidhur me sipërfaqen për student, ndriçimin natyral, ngrohjen dhe ftohjen, si dhe kërkesat për sigurinë kundër zjarrit.</i></p> <p><i>Auditoret, laboratorët, bibliotekat dhe mjediset mbështetëse</i></p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342342

	janë të pajisura me infrastrukturë bashkëkohore (videoprojektorë, rrjete wireless, pajisje teknologjike), duke mundësuar zbatimin efektiv të metodave interaktive dhe realizimin e objektivave të kurrikulës. Po ashtu, ambientet mbështesin zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare dhe kërkimin individual të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Nga vizita ne institucion - takimi me studentët dhe vizita në mjediset e bibliotekës së Universitetit Epoka, u konstatua se studentëve ju vihet në dispozicion literatura bazë fizike, materiale të shkruara si dhe marrja me shkrim, për realizimin e programit të studimit. Kjo literaturë është përgatitur nga personeli i angazhuar sipas lëndëve dhe moduleve. Studentët kanë një fond të madh të librave të lëndëve apo moduleve në bibliotekën e institucionit. Literatura e përcaktuar në sylabuset e lëndëve të programit është e 5 viteve të fundit bazuar në VKM 41/2018, e ndryshuar.</p> <p><i>Vizita në institucion - takimi me studentët dhe vizita në mjediset e bibliotekës, Shtojca 5 (1-7)</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>Nga vizita ne institucion konstatohet se Njësia përgjegjëse raporton se literatura e përdorur në programin e studimit është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme me botime të viteve të fundit. Koleksioni i bibliotekës së Universitetit EPOKA është pasuruar rregullisht përmes blerjeve dhe donacioneve nga persona fizikë dhe juridikë. Përzgjedhja e literaturës realizohet mbi bazën e nevojave të identifikuar nga stafi akademik, studentët dhe njësitë bazë, duke garantuar përputhjen me planprogramet dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Procedurat për sigurimin e literaturës së re janë të institucionalizuara dhe realizohen përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kërkesave të formalizuara nga stafi akademik dhe

	<p>studentët;</p> <ul style="list-style-type: none"> • miratimit institucional sipas rregullores përkatëse; • koordinimit të Njesisë së Bibliotekës me strukturat përgjegjëse të institucionit. <p>Në këtë mënyrë, Njësia përgjegjëse siguron që literatura mbështetëse dhe bazë e programit të studimit të jetë e përditësuar, relevante dhe në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të fushës. <i>Shtojca nr. 82</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Univeristeti Epoka u siguron studentëve akses në një bibliotekë mësimore, duke garantuar shfrytëzim të barabartë të burimeve nga të gjithë studentët e programit të studimit. Biblioteka është në shërbim të studentëve të cikleve Bachelor, Master dhe PhD, si dhe të stafit akademik dhe administrativ, dhe disponon kapacitet prej rreth 100 vendesh, një sipërfaqe përdorimi prej 400 m², mbi 25,000 libra të shtypur dhe rreth 2,000 revista akademike në format dixhital.</p> <p>Në përputhje me Rregulloren e Bibliotekës, përdoruesit kanë të drejtë të huazojnë materiale bibliografike sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara. Studentët dhe përdoruesit e jashtëm të Universitetit EPOKA nuk kanë të drejtë huazimi të materialeve, por u lejohet përdorimi i tyre vetëm brenda ambienteve të bibliotekës, pas plotësimit të formularit përkatës të shërbimit. <i>Shtojca nr. 76, Shtojca nr. 87, RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ka një numër të konsiderueshëm librash në fusha të ndryshme studimi, si dhe literaturë të lidhur drejtpërdrejt me programin e studimit. Fondi fizik dhe ai digjital pasqyrojnë nevojat e identifikuar nga njësitë bazë në lidhje me literaturën e përdorur si bazë dhe mbështetëse, në përputhje me përcaktimet ligjore për vitin e publikimit, ku literatura bazë i përket pesë viteve të fundit. Në Shtojcën nr. 81 paraqitet lista e literaturës mbështetëse të programit të studimit.</p> <p><i>Vizita në Institucion – vizita në bibliotekë Shtojca nr. 81, RVB</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në</p>	<p>Universiteti EPOKA është i abonuar në bazën e të dhënave JSTOR, e cila u ofron stafit akademik dhe studentëve akses në një bazë të gjerë burimesh shkencore. Përmes kësaj databaze mund të aksesohen mbi 2 milionë libra dhe rreth 200 revista</p>

<p>bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>akademike, që mbulojnë afërsisht 75 disiplina, përfshirë edhe fushën e programit “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”.</p> <p>Përveç JSTOR, Universiteti EPOKA disponon edhe burime të tjera elektronike, si Cambridge Journals Online, OECD iLibrary, etj. Literatura e disponueshme në bibliotekë është në disa gjuhë, kryesisht shqip, anglisht dhe turqisht, por edhe në gjuhë të tjera duke mbështetur në mënyrë të plotë nevojat akademike dhe kërkimore të studentëve dhe stafit. <i>Shtojca nr. 88, RVB</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Nga bisedat me studentët rezultoi se ata preferojnë kryesisht literaturën online në format elektronik, si artikuj shkencorë dhe libra digjitalë, në përputhje me lëndët dhe orientimin e dhënë nga pedagogët. GVJ konstatoi se biblioteka disponon vende qëndrimi të mjaftueshme për numrin e studentëve të këtij programi masteri, si dhe laboratorë të pajisur me kompjutera në funksion të procesit mësimor dhe kërkimit.</p> <p>Studentët kanë akses në deponitën digjitale online DSpace, përmes së cilës mund të përdorin burime akademike digjitale kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ata gëzojnë akses falas në bibliotekën ndërkombëtare JSTOR, ku mund të konsultojnë një gamë të gjerë artikujsh dhe punimesh akademike ndërkombëtare.</p> <p><i>Vizita në institucion - vizita në mjediset e bibliotekës, Shtojcanr. 88</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Për të mundësuar shfrytëzim të barabartë të mjedisëve të bibliotekës, ajo qëndron e hapur deri në orën 16:00. Ky orar konsiderohet i përshtatshëm për studentët. Biblioteka, në bazë të kapacitetit të saj, përmbush nevojat e studentëve dhe i përgjigjet numrit të përdoruesve brenda orarit të shërbimit.</p> <p>Bazuar në Anketën e fundit të Kënaqësisë së Studentëve, 80% e tyre kanë vlerësuar pozitivisht gjendjen e bibliotekës, duke e cilësuar si “Shumë mirë” dhe “Mirë”. Gjithashtu, në lidhje me orarin e shërbimit, 82% e studentëve kanë shprehur kënaqësi, duke e vlerësuar atë si “Mirë”, “Shumë mirë” ose “Mjaftueshëm”.</p> <p><i>Vizita në institucion - vizita në mjediset e bibliotekës, Shtojca nr. 58, Shtojca nr. 86</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e</p>	<p>Personeli akademik, informon bibliotekën për tituj të rinj, duke realizuar pasurimin e fondit të bibliotekës në mënyrë të vazhdueshme. Njësia bazë që ndjek programin e studimit njofton dhe bibliotekën për të ndjekur pasurimin e fondit të saj</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342345

<p>fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>të librit. Si pjesë e analizave vjetore institucionale, janë të dhënat mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik, të bibliotekës së Univeritetit Epoka. Biblioteka garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e çdo programi studimi e pa pagesë. Një pjesë e teksteve mësimorë që kanë lidhje me lëndët që zhvillohen në programin e studimit Bachelor “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” gjenden si në Bibliotekën e Universitetit.</p> <p><i>Vizita në institucion - takimi me studentët dhe stafin, RVB, Shtojca nr. 83</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitat në institucion, takimet me studentët dhe stafin akademik, si dhe verifikimin e dokumentacionit shoqëruar, GVJ konstaton se standardi për sigurimin, përditësimin dhe aksesin e literaturës mësimore përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Universiteti EPOKA u siguron studentëve akses të barabartë në literaturë bazë dhe mbështetëse, në format fizik dhe digjital, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41/2018, e ndryshuar, ku literatura bazë i përket kryesisht pesë viteve të fundit. Biblioteka Universitare disponon një fond të pasur librash dhe burimesh elektronike, si dhe akses në databaza ndërkombëtare prestigjioze, të cilat mbështesin në mënyrë të plotë procesin mësimor dhe kërkimor të programit të studimit.</i></p> <p><i>Procedurat për përditësimin e literaturës janë të institucionalizuara dhe funksionale, ndërsa nga bisedat me studentët dhe anketat e kënaqësisë rezulton vlerësim pozitiv për aksesin, cilësinë e burimeve dhe kushtet e shërbimit të bibliotekës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342346

institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga vizita ne Institucion dhe dokumentacioni evidentoi se institucioni disponon një sistem të integruar elektronik të menaxhimit të studentëve (Epoka Interactive System (EIS)), përmes të cilit administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët gjatë gjithë ciklit të studimit, nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi mundëson menaxhimin e të dhënave personale dhe akademike, regjistrimin e lëndëve, ndjekjen e frekuentimit, vlerësimeve, notave, kërkesave administrative dhe situatës financiare, duke siguruar transparencë, saktësi dhe akses të vazhdueshëm për studentët dhe stafin akademik</p> <p><i>Vizita në Institucion, Shtojca nr. 88, Shtojca nr. 89</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës-akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Institucioni disponon një sistem të brendshëm të integruar të menaxhimit (Epoka Interactive System (EIS)), i cili administrohet në mënyrë të centralizuar informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, si dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programeve të studimit.</p> <p>Përmes këtij sistemi menaxhohen profilet e stafit, rolet dhe përgjegjësitë, CV-të, ngarkesa mësimore, syllabuset, vlerësimet, pjesëmarrja, proceset e këshillimit akademik, si dhe dokumentacioni administrativ dhe raportet përkatëse, duke siguruar transparencë, gjurmueshmëri dhe efikasitet në menaxhimin institucional. <i>Vizita në Institucion, Shtojca nr. 89, Shtojca nr. 90</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit Epoka Interactive System (EIS) siguron akses të dedikuar, të personalizuar dhe të sigurt në informacion dhe dokumentacion për të gjithë studentët, personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ të programit të studimit. Aksesit realizohet përmes kredencialeve institucionale dhe bazohet në role dhe nivele përgjegjësie, duke garantuar që çdo përdorues të ketë akses vetëm në informacionin dhe dokumentet përkatëse.</p> <p>Studentët kanë akses në të dhënat personale dhe akademike, regjistrimet, notat, frekuentimin, transkriptat, dokumentet administrative dhe situatën financiare, ndërsa personeli akademik dhe administrativ ka akses në profilet e stafit, CV-të, ngarkesën mësimore, syllabuset, vlerësimet, listat e studentëve, dokumentacionin dhe raportet përkatëse. Ky organizim siguron</p>




	<p>transparencë, mbrojtje të të dhënave dhe menaxhim efikas të informacionit përgjatë gjithë ciklit të studimit. <i>Shtojca nr. 89, Shtojca nr. 90</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit Epoka Interactive System (EIS) ka të integruara platforma dhe module funksionale që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbim të vazhdueshëm informacioni ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Përmes EIS realizohet komunikimi lidhur me lëndët, syllabuset, vlerësimet, njoftimet akademike, frekuentimin dhe rezultatet e provimeve, duke garantuar transparencë dhe akses në kohë reale.</p> <p>Gjithashtu, sistemi është i integruar me Learning Management System (Moodle/LMS), Google Services (Email, Classroom) dhe module të tjera digjitale, të cilat mbështesin shpërndarjen e materialeve mësimore, njoftimet, vlerësimet dhe ndërveprimin akademik. Kjo infrastrukturë e integruar siguron komunikim efektiv, koordinim të vazhdueshëm dhe përfshirje aktive të studentëve në procesin mësimor. <i>Shtojca nr. 90</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit Epoka Interactive System (EIS) garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar ndjekjen e vazhdueshme të proceseve kryesore institucionale. Përmes sistemit monitorohen në kohë reale regjistrimet, ngarkesa mësimore, frekuentimi, vlerësimet, notat, progresi akademik i studentëve, si dhe aktivitetet administrative dhe financiare.</p> <p>EIS mundëson plotësimin e të dhënave sipas roleve dhe niveleve drejtuese, duke ofruar të dhëna të sakta dhe të përditësuara për organet dhe autoritetet drejtuese. Këto të dhëna në system mbështesin procesin e vendimmarrjes, planifikimin akademik dhe administrativ, si dhe rrisin transparencën dhe efikasitetin e menaxhimit institucional.</p> <p><i>Vizita në Institucion, Shtojca nr. 90, RVB</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet dhe proceset e tjera institucionale janë të publikuara në faqen zyrtare të Universitetit Epoka, e cila ofron përmbajtje në të paktën dy gjuhë, përkatësisht gjuha shqipe dhe gjuha angleze, duke siguruar akses të qartë për përdorues vendas dhe ndërkombëtarë. Përmbajtjet përfshijnë përshkrime të programeve bachelor, master dhe PhD, informacion rreth fakulteteve, stafit akademik, procedurave të pranimit, aktiviteve dhe njoftimeve, të paraqitura në gjuhën shqipe dhe në versionin ndërkombëtar/anglisht të faqes. Kjo siguron që</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342348

	<p>përdoruesit të marrin informacion në një nivel të gjerë, duke përfshirë publikun lokal dhe atë global.</p> <p>Në faqen kryesore është e publikuar përmbajtja e navigimit që lidhet me “About Us”, “Admissions”, “Academic Calendar”, “Faculties”, etj., duke reflektuar publikimin e informacionit në të dyja gjuhët e përdorura. <u>EPOKA University</u> dhe në mënyrë specifike për programin Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare <u>Department of Political Science and International Relations EPOKA University</u>.</p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në analizën përshkruese të kriterëve të GVJ, evidentohet se institucioni disponon një sistem të konsoliduar dhe funksional të menaxhimit, i cili mbështet në mënyrë efektive administrimin e informacionit akademik dhe administrativ, komunikimin ndërmjet aktorëve të procesit mësimor, monitorimin në kohë reale dhe raportimin për organet drejtuese. Sistemi garanton akses të dedikuar dhe të sigurt për studentët dhe personelin, si dhe transparencë në menaxhimin e të dhënave.</i></p> <p><i>Gjithashtu, publikimi i informacionit në faqen zyrtare të institucionit në të paktën dy gjuhë, përfshirë gjuhën shqipe, rrit dukshmërinë, aksesin publik dhe ndërkombëtarizimin e programeve të studimit. Në përfundim, bazuar në gjetjet e evidentuara, konstatohet se standardet e GVJ përmbushen plotësisht, duke kontribuar pozitivisht në cilësinë e menaxhimit institucional dhe të procesit mësimor.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për	Institucioni harton dhe administron raporte financiare të detajuara që pasqyrojnë kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, si dhe planin e mbështetjes financiare të nevojshme për garantimin e mbarëvajtjes së programeve për të paktën një cikël të plotë studimi. Këto raporte përfshijnë shpenzimet për burimet njerëzore, shpenzimet operative, infrastrukturën dhe teknologjitë mbështetëse, bibliotekën dhe

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342349

<p>mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>aksesin në burime akademike, si dhe zëra të tjerë të lidhur me realizimin e procesit mësimor.</p> <p>Planifikimi financiar realizohet në përputhje me planin strategjik dhe buxhetin vjetor të institucionit, duke siguruar qëndrueshmëri financiare, transparencë dhe përdorim efikas të burimeve. Raportet financiare dhe planet përkatëse shërbejnë si bazë për monitorimin, vlerësimin dhe vendimmarrjen e organeve drejtuese, duke garantuar mbështetje të vazhdueshme financiare për realizimin cilësor të programeve të studimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, Shtojca nr. 7, Shtojca nr. 12, Shtojca nr. 13, Shtojca nr. 74, RVB</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GJV evidenton nga dokumentacioni se plani i financimit i njësisë bazë/programit (në përputhje me kornizën institucionale dhe dokumentet planifikuese) parashikon dhe administron zërat kryesorë të financimit që garantojnë funksionimin e programit të studimit: financimin e burimeve njerëzore (personel akademik / ndihmësakademik / administrativ), shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, si dhe mbështetjen e aktiviteteve akademike e kërkimore.</p> <p>Kjo mbështetet nga parashikimet e planeve strategjike për burimet financiare dhe shpërndarjen e tyre sipas prioriteteve (përfshirë investimet dhe mbështetjen e kërkimit). Njësia/Institucioni gjithashtu parashikon shpenzime për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/akseset online, si pjesë e mbështetjes së procesit mësimor dhe cilësisë akademike, si edhe detyrime financiare dhe kontrata shërbimesh të nevojshme për realizimin e programeve. Për më tepër, dokumentet institucionale nënvizojnë autonominë dhe përgjegjësinë financiare, si dhe rolin e strukturave drejtuese në miratimin/mbikëqyrjen e përdorimit të burimeve dhe proceseve vendimmarrëse (p.sh. në nivel Senati/strukturash drejtuese dhe rregullimesh bazë). Së fundi, plani i financimit reflekton edhe burime të tjera si grantet vendase/ndërkombëtare, projektet dhe bashkëpunimet, të cilat synojnë të rrisin kapacitetet akademike/kërkimore dhe të mbështesin aktivitetet e programit, në përputhje me objektivat strategjike të institucionit.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, Shtojca nr. 7, Shtojca nr. 12, Shtojca nr. 13, Shtojca nr. 74, RVB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik,</p>	<p>Institucioni kryen auditim periodik financiar, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, dhe vlerëson në mënyrë të dokumentuar</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342350

<p>vlërëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>gjendjen e financimit dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve financiare. Procesi i auditimit dhe raportimit financiar realizohet në përputhje me kuadrin rregullator institucional dhe legjislacionin në fuqi, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe korrektësi në menaxhimin financiar.</p> <p>Rezultatet e auditimeve dhe analizat financiare pasqyrohen në raportet vjetore financiare, të cilat i paraqiten organeve drejtuese për shqyrtim dhe vendimmarrje. Këto dokumente shërbejnë për të monitoruar performancën financiare, për të identifikuar nevoja për përmirësim dhe për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të programeve të studimit për një cikël të plotë akademik, në përputhje me përcaktimet e Statutit, Rregullores dhe dokumenteve strategjike të institucionit.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, Shtojca nr. 7, Shtojca nr. 12, Shtojca nr. 13, Shtojca nr. 74, RVB</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni realizon raportim financiar periodik mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës, deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky raportim përfshihet në raportet vjetore financiare dhe administrative dhe pasqyron të ardhurat, shpenzimet sipas zërave buxhetorë, si dhe nivelin e realizimit të tyre në krahasim me planifikimin fillestar.</p> <p>Raportet i paraqiten strukturave dhe organeve drejtuese për analizë dhe miratim, duke shërbyer si bazë për vlerësimin e performancës financiare, rishikimin e planifikimit dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve. Ky proces garanton transparencë, llogaridhënie dhe gjurmueshmëri në përdorimin e fondeve, si dhe mbështet vendimmarrjen e informuar në funksion të mbarëvajtjes së programeve të studimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, Shtojca nr. 7, Shtojca nr. 12, Shtojca nr. 13, Shtojca nr. 74, RVB</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin dhe funksionimin normal të programeve të studimit të njësisë bazë, duke siguruar kapacitete financiare të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të burimeve njerëzore, infrastrukturës, teknologjive mbështetëse, bibliotekës dhe aktiviteteve akademike e kërkimore. Planifikimi financiar realizohet në mënyrë afatmesme dhe afatgjatë, në përputhje me dokumentet strategjike dhe buxhetin vjetor të institucionit.</p> <p>Në rastet kur identifikohen nevoja për përmirësim të situatës</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342351

<p>financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>financiare, institucioni parashikon dhe planifikon ndërhyrje të posaçme, përfshirë rishikimin e prioriteteve buxhetore, optimizimin e shpenzimeve dhe diversifikimin e burimeve të financimit. Këto përfshijnë përfitimin e granteve vendase dhe ndërkombëtare, projekte kërkimore, bashkëpunime me partnerë institucionalë dhe kontrata shërbimesh, me qëllim sigurimin e vijueshmërisë dhe cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 1, Shtojca nr. 7, Shtojca nr. 12, Shtojca nr. 13, Shtojca nr. 74, RVB</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka ndërtuar dhe zbaton në mënyrë të qëndrueshme një sistem funksional të planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit financiar, i cili garanton mbështetjen e nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit.</i></p> <p><i>Institucioni demonstroi planifikim financiar afatmesëm dhe afatgjatë, raportim dhe auditim periodik, si dhe mekanizma transparente për ndjekjen e realizimit të buxhetit deri në nivel njësie bazë. Gjithashtu, evidentohet disponimi i kapaciteteve financiare të mjaftueshme dhe aftësia për të planifikuar ndërhyrje të posaçme dhe për të diversifikuar burimet e financimit në rast nevojë.</i></p> <p><i>Në përfundim, GVJ vlerëson se Standardi IV.5 përmbushet plotësisht, pasi kriteret për financimin, qëndrueshmërinë financiare, transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e burimeve janë të përmbushura në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342352





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ, bazuar në vizitën në institucion si dhe nga shqyrtimi i RVB, konstatoi se Universiteti Epoka ka politika dhe procedura të institucionalizuara të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin në përfundim të ciklit të studimeve. Të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MAS.</p> <p>Rregullorja e IAL përcakton politikat dhe procedurat në lidhje me kuotat e studentëve për çdo vit akademik në bazë të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore. Bazuar në aplikimet e marra përmes portalit U-Albania, EPOKA përgatit listën e studentëve fitues dhe pas publikimit në portalin e U-Albania ato publikohen edhe në faqen web të institucionit. Pas rregjistrimit të gjithë studentët pajisen me numër matkulimi nga QSHA dhe me kartën e studentit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. <i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 7, shtojca nr. 78</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjësin e Departamentit dhe sidomos GVB, u informua se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi propozohet nga Bordi Administrimit dhe miratohen nga Ministria e Arsimit. Kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi duhet të plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara nga MAS.</p> <p>Statuti dhe Rregullorja e IAL përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha proceset nga rregjistrimi, deri tek përfundimi i studimeve apo transferimet në programe të tjera studimi duke ofruar transparencë në proces dhe barazi në trajtimin e studentëve. Të gjitha ambientet dhe godinat e institucionit janë pajisur me ashensorë ose me rampa për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara. <i>Shtoja nr. 1, shtojca nr. 7</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton në rregjistrimin e studentëve në respekt të legjislacionit në fuqi sic janë Ligji 80/2015 miratuar nga MAS dhe Këshilli i Ministrave si edhe kuadrin ligjor institucional sic është vendimi i Senatit nr. 89 datë 27/01/2023. Universiteti shikon cdo vit listat e aplikantëve për secilin program dhe kryen renditjen e fituesve, në përputhje me kuotat e miratuara nga Ministria dhe i gjithë informacioni i referuar pranimit dhe transferimit publikohet në faqen kryesore të institucionit dhe në rrjetet sociale.</p>

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342353

<p>shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Gjithashtu bën publike dhe kriteret që duhet të plotësojnë studentët e huaj që dëshirojnë të ndjekin programin e studimit.</p> <p><u>Bachelor Programs EPOKA University</u></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga analiza e RVB GVJ identifikoi se IAL harton e publikon çdo vit akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve. Kriteret e pranimit për programin rishikohen çdo vit nga departamenti në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe janë në përputhje me LALKSH 80/2015, me rregulloren e fakultetit dhe rreguloren e programit të studimit.</p> <p>Senati Akademik i IAL vendos kuotat e pranimit të programeve të ciklit të parë dhe të dytë. Studentët që kanë kryer studimet në shkollën e mesme në gjuhë të huaj (anglisht) përjashtohen nga provimi hyrës i gjuhës së huaj. <i>Shtojca nr. 2; Shtojca nr. 47</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Epoka informon lidhur me programet zyrtare përmes faqes web (www.Epoka.edu.al) ku ofrohet informacion jo vetëm publikut por edhe studentëve dhe stafit, lidhur me programet e studimit, karakteristikat e tyre, kurrikulat, si edhe aktivitetet studentore, kulturore dhe shkencore të organizuara nga institucioni. Një sërë aktivitetesh marketingu si reklama, orë të hapura, takime promovuese, të organizuara nga Epoka apo publikime si broshuara, students-book, etj synojnë tërheqjen e sa më shumë studentëve. Për të tërhequr më shumë maturan të, EPOKA organizon orë të hapura, takime maturan të dhe merr pjesë në panaire tematike Universiteti organizon edhe provimin e bursës për t'u dhënë studentëve ekselentë mundësi për të përfituar 100% bursë gjatë periudhës së studimeve. Nga vizita në institucion, sidomos nga takimi me studentët, GVJ vëreu se studentët ishin të mirë-informuar mbi programin e studimit dhe të kënaqur nga niveli i informacionit që i vihej në dispozicion.</p> <p>https://epoka.edu.al/en/MTA1Njc=/news/2023-epoka-university-hosts-open-day-for-prospective-students</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe</p>	<p>Në këtë program studimi nuk kishte të regjistruar studentë me aftësi të veçanta apo nga shtesa të marginalizuara pasi edhe numri i studentëve ishte i limituar. Gjithsesi, nga vizita në institucion GVJ u informua se institucioni ofronte bursa ekselence si dhe bursa sociale ku përfshiheshin edhe persona nga shtesa të marginalizuara dhe me aftësi të kufizuara fizike.</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342354

<p>shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në tërësi, institucioni publikon në fillim të çdo viti kuotat në dispozicion të studentëve që vijnë nga kategori të veçanta sociale, në zbatim të kriterëve që janë vendosur nga Ministria e Arsimit. Gjithashtu, Epoka është partner në projektin IDEA të Erasmus+ me qëllim përmirësimin e aksesit dhe krijimin e kushteve gjithëpërfshirëse të mësimdhënies dhe zhvillimit të mundësive të punësimit për studentët me aftësi ndryshe. <i>Shtojca nr. 56</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Kuotat e pranimit për studentët me shtetësi të huaj publikohen përpara çdo viti akademik dhe kriteret që ndiqen janë ato të publikuara nga Ministria e Arsimit për këtë qëllim. Kandidatët me shtetësi të huaj duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin përkatës të Keshillit të Ministrave për pranimin në programet e ciklit të parw dhe të dytë.</p> <p>https://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-495-1926.html?lang=EN&dpid=2&t=admissioncriteria&catid=495&menuid=1926</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në që zhvilluam në IAL rezultojnë se Universiteti EPOKA përpiqet të jetë më afër komunitetit duke dhënë bursa të bazuara në merita për studentët me arritje të larta dhe jep bursa sociale për një grup studentësh në nevojë. Ka bursa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Fëmijë të policisë të vrarë në krye të detyrës. ➤ Jetimët vijnë nga familje me të ardhura të ulëta. ➤ Studentë që i përkasin komunitetit rom/egjiptian. ➤ Sportist me rezultate të larta në kategorinë sportive olimpike përkatëse Nxënës nga bashkia Vorë. <p><i>Shtojca nr. 51/neni 4</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Epoka ka hartuar dhe zbaton procedura dhe politika të qarta për pranimin e studentëve në programet akademike dhe përzgjedhjen e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi.</i></p> <p><i>Bazuar në dokumentacionin dhe gjetjet e verifikuara gjatë vizitës, GVJ konstaton se Universiteti Epoka e përmbush standardin, duke demonstruar një kuadër rregullator të qartë dhe të harmonizuar me Ligjin nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore të MASR.</i></p> <p><i>Procedurat për pranimin, regjistrimin, transferimin, njohjen e krediteve dhe diplomimin janë të standardizuara, të dokumentuara dhe publikohen paraprakisht, duke garantuar</i></p>

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342355

	<i>transparencë dhe akses të barabartë për kandidatët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Procedurat e progresit akademik përcaktohen në rregulloret e IAL dhe njësisë bazë që ofron programin të cilat u vihen në dispozicion studentëve. Po aq e rëndësishme sekretaria mësimore është në dispozicion gjatë gjithë vitit akademik për të informuar dhe ndihmuar studentët në lidhje me orarin mësimor, frekuentimin, datat dhe provimeve.</p> <p>Si rregull, studenti njihet me rregulloren e programit, e cila përcakton kriterit e progresit në varësi të përmbushjes së kërkesave akademike. Informacioni zyrtar mbi notat është pjesë e sistemit të menaxhimit të universitetit. Falë Sistemit EIS, stafi akademik me kohë të plotë dhe studentët kanë akses në sistemin e menaxhimit jo vetëm për të rregjistruar notat por edhe njohur rezultatet e arritura si edhe për të verifikuar ecurinë e studentëve dhe për të bërë këshillimet e nevojshme mbi progresin akademik. <i>Shtojca nr. 2</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit. Komisioni mund të njohë deri në 60 ECTS. Studentët që kanë dhënë një lëndë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, kanë të drejtë të bëjnë kërkesë dhe të përjashtohen nga detyrimi i dhënies përsëri të lëndës. <i>Shtojca nr. 7, shtojca nr. 74</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të	<p>Nga analiza e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe sidomos syllabuseve, GVJ vëren se kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe bazë si edhe në syllabuset të çdo lënde. Duke qënë se programi u bëhet i ditur</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-4342356

<p>studentëve në programin e studimit.</p>	<p>studentëve që orën e parë të lëndës, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit në fillim të çdo semestri.</p> <p>Specifikisht, neni 37 i “Rregullores për Programet e Studimeve të Ciklit të Dytë informon studentët për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të njohurive dhe aftësive gjatë programit të studimit. Epoka operon me sistemin Evropian të Arsimit të Lartë të Krediteve si njësi matëse e ngarkesës akademike. Studentët gjithashtu mund ta gjejnë informacion në faqen zyrtare të internetit. <i>Shtojca nr. 2, shtojca nr. 78, shtojca nr. 5</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga analiza e rregullores së institucionit, njësisë kryesore dhe asaj bazë, GVJ vëren se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit janë të përcaktohen qartë dhe saktë.</p> <p>Specifikisht Rregullorja e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë dhe Rregullorja e Universitetit Epoka përcaktojnë parakushtet, kriteret dhe procedurat për projektin e diplomimit. Informimi i studentëve lidhur me këto kërkesa dhe procedura zhvillohet nga departamenti. Për të plotësuar këto parakushte, studentët kanë të drejtë të hyjnë në provime plotësuese jo më shumë se tre herë. Studentët paraqesin një dokument që i kanë kryer të gjitha detyrimet prej 60 ECTS për të marrë diplomën e masterit profesional. <i>Shtojca nr. 2, shtojca nr. 78, shtojca nr. 5</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua, dhe konfirmua nga takimi me studentët, se në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime me studentët (aktual dhe potencial) për t’i informuar mbi programet e studimit. Këto informacione përcillen, ndër të tjera, përmes panairëve, masmedias, si edhe fletëpalosjeve dhe posterave. Të gjitha programet e studimit kanë një koordinator, i cili në bashkëpunim me skretarinë mësimore mundëson informacion për studentët aktual dhe potencial.</p> <p><i>Vizita në Institucion - takimi me studentët, shtojca nr. 50</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka politika të qarta dhe të sakta për informimin e studentëve aktual dhe potencial mbi të gjitha elementët e programit të studimit.</i></p> <p><i>Institucioni ka të përcaktuar rregullat mbi kriteret e vlerësimit të studentëve. Studentët informohen nga strukturat përkatëse akademike dhe administrative për vlerësimet dhe për numrin e krediteve të përftuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342357

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Siç jemi shprehur disa herë edhe më sipër, informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit fillon që në takimet që zhvillohen me studentët potencialë, me orientimin kur ato aplikojnë, e vijojnë gjatë kohës së studimeve. Informacioni mbi strukturën e programit të studimit afishohet gjithashtu edhe në stendat e universitetit, në SMS si edhe në faqen e internetit të Epoka.</p> <p>Kryesisht, Zyra e Pranimit informon studentët mbi strukturën e programeve duke harmonizuar takimet në zyrë me faqen zyrtare https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html ku studentët gjejnë të gjithë informacionet e nevojshme mbi programet e studimit, sic jane kohëzgjatja e programit, tarifat e studimit, përbërja e lëndëve etj. <i>Shtojca nr. 1, shtojca nr.4</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ-së iu konfirmua që studentët njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit që ditën e parë dhe në orën e parë të mësimi u bëhet i njohur programi i lëndës. Po aq e rëndësishme, një pjesë e këtij informacioni afishohet fizikisht në ambjentet e institucionit. Studentit i ofrohet i gjithe informacioni i nevojshëm si syllabuset që në javën e parë të studimeve, ndërsa cdo student ndiqet nga një pedagog që është pjesë e departamentit. Studentëve ky informacion i ofrohet edhe online nëpërmjet programit EIS si edhe u krijohet mundësia për tu takuar me pedagogët dhe për të marrë më shumë informacion mbi programin. Studentët informohen gjithashtu edhe për akreditimin e programeve dhe të institucionit dhe vlefshmërinë e diplomës. <i>Shtojca nr. 4</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në	<p>Në nivel institucional, GVJ vëren se Epoka është aktiv në mbështetjen e punësimit të studentëve duke marrë pjesë në panairë, takime me biznese të profilit, etj. Institucioni informon si studentët potencialë dhe aktual mbi mundësitë e punësimit që ofron programi i studimit nëpërmjet faqes zyrtare të IAL-së, rrjeteve sociale, si dhe takimeve dhe informimeve të kryera nga</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342358

tregun e punës.	zyrat përkatëse. Specifikisht Epoka ka një Zyrë për Planifikimin e Karrierës dhe te Diplomuarve e cila informon studentët në lidhje me nevojat e tregut të punës duke ofruar edhe seanca këshillimore. Një nga aktivitetet më të rëndësishme të Zyrës është Panairi i përvitshëm i Karrierës, i cili bashkon përfaqësues të institucioneve publike, biznesit, por edhe Alumni të diplomuar pranë Epoka. Në Panairin e fundit morën pjesë 100 kompani, të cilat ofruan mundësi punësimi apo projektsh studimore për studentët. <i>Shtojca nr. 69, shtojca nr. 95</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga sa kemi thënë më sipër, bazuar në RVB si dhe në vizitën në institucion, studentëve i vihet në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm. Një përshkrim i plotë i ambienteve të logjistikës ofrohet që në fillim të programit, ndërsa gjatë vizitave të organizuara në institucion, studentët apo kandidatët informohen mbi shërbimet e ofruara për studentët, informacionet lidhur me programin e studimit, logjistika institucionale, etj. Këto informacione ofrohen edhe gjatë ditëve të hapura të organizuara në fillim të cdo viti akademik për këtë qëllim nga të gjitha strukturat e IAL në shërbim të studentit, por edhe nga pedagogu gjatë javës së parë në prezantimin e cdo lënde. <i>Shtojca nr. 78</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Pasi studentët rregjistrohen në Epoka, Zyra Kordinuese e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit u siguron një emër përdorimi dhe kod për të patur akses në listën e tyre të notave, mungesat e kryera, si edhe situatën e tyre financiare. Kjo procedurë kryhet në sistemin e menaxhimit (EIS) dhe akses i mundësohet në cdo ambient nga ku mund të ketë lidhje me internet. <i>Shtojca nr. 89</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të qarta e të institucionalizuara mbi informimin e studentëve për organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme dhe mundësitë e punësimit.</i> <i>Organizimi, struktura akademike, objektivat formuese, kurrikula e programit të studimit, janë të përcaktuar në rregulloren e këtij programi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342359

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.

GVJ vëren se në nivel institucional Epoka mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në programin e studimit. Specifikisht, sekretaria mësimore mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore. Referuar (Tabelat Permbledhese [Shqip] tab nr. 23), numri i të diplomuarve për këtë program studimi sipas viteve është si më poshtë:

Viti akademik	Nr i të diplomuarve	Të punësuar në përputhje me diplomën	Të punësuar jo në përputhje me diplomën
2021-2022	16	8	1
2022-2023	15	8	0
2023-2024	9	3	3

Këto të dhëna dokumentohen në “Raportin Vjetor”, i cili përgatitet nga Zyra e Karrierës si pjesë e detyrimit ligjor të IAL. Të dhënat që përpunohen nga Zyra e Karrierës përfshijnë punësimin e studentëve, si edhe përputhshmërinë e punësimit me drejtimin e diplomimit. Mbajtja e të dhënave është relativisht e lehtë duke patur parasysh edhe numrin e ulët të student Shtojca nr. 75, shtojca nr. 95

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i

Sistemi i menaxhimit të të dhënave mundëson përditësimin dhe hedhjen e të dhënave personale të studentëve në performancën akademike dhe në situatën financiare, përfshirë edhe studentët e rregjistruar dhe të larguar. Në këtë mënyrë krijohet një tablo në kohë reale e studentëve që janë në programet e studimit, atyre që janë shkëputur përkohësisht apo përgjithmonë. Ky përditësim ndihmon Sekretarinë Mësimore që të ofrojë të dhëna të sakta që nevojiten si për zbatimin e legjislacionit në fuqi ashtu edhe raporteve apo studimeve të kryera nga vetë institucioni. Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion numri i studentëve për këtë program studimi për katër vitet akademike është si më poshtë vijon:

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342360

studimeve.	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të transferuarve	Nr total
	2021-2022	11	1	12
	2022-2023	10	0	10
	2023-2024	11	0	11
	2024-2025	4	1	5
<i>Shtojca nr. 75, shtojca nr. 95</i>				
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore regjistron informacionin (notën) mbi ecurinë e studentëve gjatë programit të studimit deri në diplomim. Të dhënat mbahen elektronikisht në sistemin e universitetit (EIS) dhe në <i>hard copy</i> në regjistrat e notave dhe të diplomave të Sekretarisë Mësimore. Ndërsa të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin themeltar. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore GVJ vuri re se të dhënat ishin të sakta dhe të mbajtura sipas kërkesave ligjore. <i>Shtojca nr. 89</i>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Për të kryer auditimin e brendshëm të njësive administrative, insitucioni ka ngritur Grupin e Auditimit të Brendshëm, i cili ka si objektiv kontrollin në mënyrë periodike të procedurave dhe rregullave të përshkruara në rregulloren e funksionimit të zyrave administrative. Grupi i Auditimit përpilon një raport vjetor ku përfshihen mangësitë e vërejtura si edhe ofrohen sugjerime për përmirësimin e tyre duke u udhëhequr nga Politika e Cilësisë. <i>Shtojca nr. 106</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të	GVJ konstaton se njësia bazë ndërmerr periodikisht analiza të tilla. Gjithësesi, duke qenë se ky program studimi ka një numër të ulët studentësh, mund të kryhen vetëm ‘analiza’ deskriptive dhe jo shumë të dobishme. Me vlerë do të ishte një studim mbi arsyet e numrit të ulët të studentëve dhe mënyrave për ta adresuar atë. <i>GVJ sugjeron që njësia bazë në bashkëpunim me Zyrën e</i>			

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342361

tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p><i>Karrierës të analizojnë arsyet e numrave të ulët të regjistrimeve dhe të bëjë një plan pune për rritjen e regjistrimeve.</i></p> <p><i>Shtojca nr. 95, shtojca nr. 97</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta dhe zyra të dedikuara për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për profilin dhe studentëve të programit të studimit.</i></p> <p><i>Të dhënat disponohen dhe përditësohen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve të brendshme, të miratuara nga institucioni.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që njësisia bazë në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës të analizojnë arsyet e numrave të ulët të regjistrimeve dhe të bëjë një plan pune për rritjen e regjistrimeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në analizën e RVB-së dhe vizitën në institucion, GVJ vuri re se studentët në Epoka janë të organizuar zyrtarisht nëpërmjet Këshillit të tyre Studentor. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Epoka. Ky Këshill, bazuar në rregulloren e institucionit, merr pjesë në vendimmarrjen e institucionit dhe konsultohet në mënyrë të strukturuar për të vjelur mendimin e studentëve. Sa më sipër rregullohet specifikisht në <i>nenin 118</i> të Statutit i cili saknksionon pjesmarrjen e studentëve në vendimmarrjet institucionale. Në Statutin e Këshillit parashikohet edhe përfshirja e një studenti të zgjedhur nga Këshilli Studentor në komisionin disiplinor. <i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 55</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se	Bazuar në analizën e GVB dhe vizitën në institucion, GVJ evidentoi se studentët përfshihen në procesin e sigurimit të

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342362

<p>përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>brendshëm të cilësisë, në klube të ndryshme, në këshillin e studentëve ku gjenden përfaqësuesit e çdo viti dhe programi, si dhe në Senatin akademik. Specifikisht, Epoka saknsonon të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në vendimmarrje në instanca si: Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Bordi i Etikës, dhe Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët. Një student është gjithashtu pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjatë procesit të akreditimit siç u pa edhe në takimin me Grupin e Punës për Hartimin e RVB.</p> <p><i>Shtojca nr. 55</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nga analiza e RVB dhe vizita në institucion, GVJ evidenton se ky program studimi është brenda parametrave ligjore dhe sidomos ngarkesës akademike të studentëve dhe ndarjes sipas Veprimtarive Formuese nga A në E në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41. Si anëtarë të Senatit Akademik dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që janë organet kompetente për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të programit, studentët janë pjesë e procesit të hartimit dhe përmirësimit të programeve. <i>Shtojca nr. 1</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Epoka aplikon disa metoda për përfshirjen e studentëve me qëllim tërheqjen e mendimit të tyre mbi cilësinë e programit të studimit si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Formularët për vlerësimin e pedagogëve dhe lëndëve; ● Përmes studentit si përfaqësues në Senat; ● Përmes studentit si përfaqësues në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; ● Përmes fokus grupeve; <p>Gjithashtu, bazuar në rregulloren e njësisë bazë, studentëve të këtij programi ju mundësohet e drejta për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e rezultateve dhe reflektimin e ndryshimeve. Specifikisht, studenti ka të drejtën e ankimimit për notën e provimit brenda 5-ditëve nga marrja e notës. Sikundër GVJ u inofrmua në takimin me studentët e programit, këta të fundit nëpërmjet Këshillit Studentor paraqesin ankimet e tyre për çdo element të aktivitetit të tyre në institucion, të cilat merren në shqyrtim nga instancat përkatëse. <i>Shtojca nr. 31, shtojca nr. 40</i></p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342363

Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka një politikë të strukturuar për përfshirje kapilare të studentëve në vendimmarrje duke filluar nga Senati akademik e deri tek GVB individuale.</i></p> <p><i>Studentëve ju merret mendim dhe ju dëgjohët zeri për sygjerime apo problematika të ndryshme që ata mund të kenë, jo vetëm për jetën e tyre akademike, por edhe atë sociale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrjnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Zyra e Regjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve ofrojnë informacionin e plotë të nevojshëm për studentët, si edhe mbajnë kontakte të vazhdueshme me ta, për të siguruar një shërbim sa më të mirë ndaj tyre. Të gjitha shërbimet dhe informacionet janë të përcaktuara në Rregulloren Themelore të Institucionit, ndërsa Zyra e Regjistrimit mban kontakte të vazhdueshme me studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim, për jetën akademike dhe atë sociale të tyre.</p> <p><i>Shtojca nr. 7, Vizitë në Institucion - takimi me studentët</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Zyra e Regjistrimit informon studentët përmes emaileve, takimeve në zyrë, broshurave apo përmes dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet sistemit EIS, ditës së orientimit për studentët e rinj por edhe faqes së internetit, informacionet lidhur me karakteristikat e programit të studimit. Studentët mund të kenë edhe takim me pedagogët apo pjestarët e stafit akademik përgjegjës për programin, ndërsa informacioni më i detajuar lidhur me planin mësimor, syllabus i lëndëve, datat e provimeve etj ofrohet nga këshilluesi akademik. <i>Shtojca nr. 78</i></p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës fokusohet në përthithjen e nevojave të tregut të punës dhe këshillimin e studentëve lidhur me këto nevoja dhe ndan këtë informacion si me Zyrën e Cilësisë ashtu edhe me departamentet përkatëse në mënyrë që programet e studimit të përgatisin studentë me profile sa më të</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342364

<p>studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>kërkuara në tregun e punës.</p> <p>Kjo Zyrë i ofron studentëve këshillat e nevojshme lidhur me mundësitë e karrierës nëpërmjet takimeve individuale, panairove dhe ëorkshopeve tematike të organizuara për këtë qëllim, si edhe nëpërmjet informacionit të publikuar lidhur me analizat mbi tregun e punës, të cilat publikohen në të gjitha kanalet e institucionit.</p> <p><i>Shtojca nr. 46</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Siç e thamë edhe më sipër, institucioni ka zyra, rregullore e politika në lidhje me tregun e punës dhe marrjen e të dhënave të punësimit. Gjithsesi për këtë program studimi, përpunimi statistikor i këtyre të dhënave është i vështirë pasi numri i studentëve është i ulët.</p> <p>Kontaktet me industrinë dhe insitucionet mbahen nga Zyra e Karrierës dhe Alumni falë kontakteve që ata kanë në mënyrë të vazhdueshme me Alumni por edhe anketës që organizohet me institucionet publike dhe kompanitë ku janë punësuar studentët</p> <p><i>Shtojca nr. 97</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka politika të qarta për këshillimin e studentëve dhe lidhjen e tyre organike me tregun e punës.</i></p> <p><i>Zyra e Karrierës dhe Alumni luan një rol tejet të rëndësishëm si gjatë kohës së ndjekjes së procesit mësimor në auditor dhe gjatë praktikës profesionale, ashtu edhe lidhur me përgatitjen për në tregun e punës. Zyra mbledh të dhënat për studentët në proces dhe për alumnit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342365

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ, bazuar në dokumentacionin e depozituar si dhe takimet gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Epoka në zbatim të Ligjit 80/2015 ka ngritur strukturën e NJSBC dhe Zhvillimit të Karrierës reflektuar në statut dhe rregulloren e përgjithshme të institucionit. Specifikisht, strategjia institucionale e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit 2024-2028 përfshin integrimin e teknologjive të avancuara, rishikimin e programeve mësimore, jo vetëm për të sansksionuar këto aktivitete por edhe për t'iu përgjigjur nevojave të tregut. Për aplikimin e këtyre strategjive, stafi institucionit merr pjesë në trainimet e organizuara nga NJSBC dhe ekspertët e jashtëm. Punë e veçantë bëhet për trainimin e stafit në mënyrë periodike dhe nxitjen e zhvillimit të vetëvlerësimit kritik, sidomos me pedagogët e rinj të cilët trainohen për mënyrë e përgatitjes së programeve, kurikulave dhe shpjegimin e rregulloreve përkatëse. <i>Shtojca nr. 12</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, (KPSC), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Departamentet përkatëse në çdo fakultet, përbëjnë strukturat përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin në mënyrë të vazhdueshme të cilësisë. KPSC është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme lidhur me vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike dhe atyre mbështetëse për studentët për të garantuar respektimin e dispozitave ligjore në fuqi. Nën monitorimin e KPSC, NJSBC harton pyetësorët për studentët, të cilët kryhen dy herë në vit. <i>Shtojca nr. 43, shtojca nr. 31, shtojca nr. 44, shtojca nr. 28</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Epoka inkurajon përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, si edhe ofrimin e sugjerimeve nga studentët duke e konsideruar si një shtytës për të arritur objektivat e mësimdhënies. Këto pyetësore jo vetëm që përmirësojnë metodologjitë mësimore, por edhe sjellin në vëmendje pakënaqësitë e studenteve, ndërsa mënyra për ta shprehur shqetësimet apo sugjerimet e studentëve ekziston nëpërmjet procesit të ankimit pranë Dekanit të Studentëve. Gjatë vizitës në IAL, GVJ gjithashtu konstatoi se studentët

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342366

	anketoheshin në përfundim të semestrit para provimit. Po aq e rëndësishme, në pyetësor ka edhe pyetje për të vlerësuar cilësinë e punës së stafit administrativ. <i>Shtojca nr. 31, shtojca nr. 93</i>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Bazuar në takimin që GVJ zhvilloi me pedagogët, NJSBC njofton pedagogun për rezultatet e anketimit si dhe hapat e mëtejshëm të procesit. Ky informacion përfshihet edhe në vlerësimin vjetor të pedagogut dhe dokumentohet në dosjen e tij të punës. Specifikisht, në kuadër të transparencës, KPSC dhe NJSBC publikon raportet përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të IAL duke përfshirë edhe raportet e grupit të vlerësimit të brendshëm dhe atë të jashtëm. <i>Shtojca nr. 43, shtojca nr. 31</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Për të nxitur zhvillimin profesional, IAL mundëson për vlerësimin e stafit duke përcaktuar objektivat e tyre për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor nëpërmjet formularit përkatës i cili ka 5 nivele dhe pedagogët duhet të arrijnë nivelin 3.0-3.5 për t'u konsideruar se përmbushin pritshmëritë. Koordinatori i departamentit ia percjell këto raporte dekanit, duke i kërkuar pedagogëve që të vlerësojnë se si janë plotësuar këto objektiva, ofron trainimet e nevojshme për t'i nxitur pozitivisht performancën individuale të çdo pedagogu dhe vendos për promovimin e pedagogut dhe mbështjetjen për kërkimet shkencore, pjesmarrjen në konferenca etj. <i>Shtojca nr. 28, shtojca nr. 29</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të institucionalizuara për procedurat dhe njësitë përgjegjëse për promovimin dhe garantimin e cilësisë të cilat janë kompetente dhe funksionale.</i> <i>Institucioni ka ngritur strukturat e duhura, përmes së cilave realizon kontrollin e performancës së stafit akademik si dhe cilësinë e mësimdhënies.</i> <i>Në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, sipas parashikimeve statutore dhe të akteve të tjerë të brendshëm, institucioni ka mundur përfshirjen e studentëve, të cilëve iu jepet mundësia për të vlerësuar format dhe metodat e mësimdhënies çdo vit, nëpërmjet pyetësorëve që realizohen në fund të zhvillimit të çdo semestri.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al
Tel:+355 (04) 222-4342367

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Siç u shprehëm edhe më lart Epoka ka strukturat e sigurimit të cilësisë por edhe procedurat e zhvilluara për këtë qëllim në përputhje me legjislacionin dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtare. Specifikisht, në Statutin e Universitetit përcaktohet roli i strukturave bazë si KPSC dhe NjSBC, por edhe nënstrukturave ndihmëse si Komisioni i Zhvillimit të Programeve Mësimore, Bordi i Provimeve, Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të cilësisë. Për të mbështetur më tej zbatimin e këtyre procedurave KPSC ka hartuar edhe rregulloren përkatëse si edhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë <i>Shtojca nr. 43, shtojca nr. 44</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se strukturat e sigurimit të cilësisë KPSC dhe NJSBC funksionojnë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, statutin e IAL dhe rregulloret përkatëse. KPSC së bashku me NJSBC janë strukturat përgjegjëse për kontrollin e cilësisë. KPSC përbëhet nga anëtarë të stafit akademik eksperti i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve, ndërsa NJSBC përbëhet nga dy anëtarë të stafit administrativ dhe një ekspert i jashtëm me profil akademik. NJSBC në bashkëpunim me fakultetet/departamentet organizon e finalizon formën e vlerësimit dhe performancën e pedagogut. NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësive aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale, Planin Strategjik Pesë-vjeçar si edhe Planin e Veprimit brenda institucionit. <i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 29, shrojca nr. 43, shrojca nr. 95</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se manuali i Sigurimit të Cilësisë është dokumenti bazë për KPSC për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet nëpërmjet proceseve të akreditimit dhe Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Për të

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342368

përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	plotësuar sa më mirë rekomandimet e lëna gjatë akreditimeve, KPSC dhe NJSBC hartojnë një plan që ndjek në vijimësi zbatimin e këtyre rekomandimeve. <i>Shtojca nr. 43</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se strukturat e ngarkuara për sigurimin e cilësisë gjenerojnë analiza dhe raporte të vazhdueshme duke përfshirë format e vlerësimit të pedagogëve të përmendura më lart. Raportet i dorëzohen Koordinatorit të Departamentit, Dekanit dhe Rektoratit duke përfshirë edhe rekomandimet përkatëse të NJSBC dhe KPSC për përmirësimin e mëtejshëm. Secili anëtar i stafit akademik përveç mësimdhënies është i angazhuar edhe në kërkimin shkencor, në grupet e punës akademike dhe në projekte mobiliteti si Erasmus+ apo Cost dhe kjo veçanërisht për pedagogët e rinj, të cilët për një periudhë tre vjeçare kanë një buxhet vjetor prej 750 euro për të financuar pjesmarrjen e tyre në aktivitete shkencore dhe akademike. <i>Shtojca nr. 28, shtojca nr.68, shtojca nr.64</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni ka krijuar dhe zbatuar në mënyrë kapilare procedura të dedikuara e publike për sigurimin e bendshëm të cilësisë.</i> <i>Informacioni i siguruar nga këto struktura i përcillet drejtuesve të cilat i përdorin për të përmirësuar politikat e brendshme dhe orientuar burimet mbështetëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor	Departamenti është struktura përgjegjëse për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Procesi i mbikqyrjes së programeve të

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342369

<p>mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>studimit dhe stafit akademik bazohet në analizën e objektivave të vendosura si në nivel individual ashtu edhe në nivel departamenti duke u bazuar në politikën për përmirësimin e vazhdueshëm.</p> <p>Në përfundim të vitit akademik bëhet hartimi i raporteve në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e kryera si edhe propozimet për përmirësimin e programeve mësimore, të cilat shqyrtohen nga Senati Akademik. IAL zhvillon analiza vjetore për vlerësimin e ecurisë së studentëve në programet e studimit, ku përfshihen të dhëna për aspektet akademike dhe performancën e studentëve, nivelin e kalueshmërisë, shkallën e diplomit dhe punësimit, etj, të cilat integrohen në raportet vjetore të njësisë bazë. Të gjitha raportet e hartuara përmbledhen në raportin përfundimtar institucional, i cili miratohet në Senat dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 75, shtojca nr. 27, shtojca 101</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit përfshijnë sugjerimet e studentëve falë anketave të përgatitura 2-3 herë në vit, kontributin e Dekanit Studentor, arritjet e personelit akademik si dhe identifikojnë praktikën më të mira.</p> <p>Siç u theksua edhe gjatë takimit me stafin skadematik, kjo praktikë bashkërendohet si me vlerësimet e jashtme falë edhe anëtarit të jashtëm të KPSC por dhe duke shpërndarë përvojën e përparuar brenda institucionit për të stimuluar më tej arritjen e rezultateve sa më të larta.</p> <p><i>Shtojca nr. 30</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Epoka përdor një sërë mekanizmesh për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë si vlerësimet e studentëve, kolegëve, alumni dhe partnerëve të IAL. Një tjetër mekanizëm i përdorur për rritjen e cilësisë është edhe organizimi i seminareve akademike, procesi i rishikimit të sillabuseve ku merret në konsideratë edhe mendimi i studentëve, procesi i monitorimit të programeve mësimore, etj të cilat bëhen transparente për të zbatuar një proces sa më të</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342370

<p>provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>drejtë dhe gjithëpërfshirës.</p> <p><i>Shtojca nr. 4, shtojca nr. 27</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se të gjitha grupet e interesuara si studentët aktualë apo ata të diplomuar, stafi akademik dhe administrativ përdorin instrumentat e lartë-përmendura për të bërë vlerësimin e performances së programeve të studimit.</p> <p>Po aq e rëndësishme, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve mban kontakte të vazhdueshme me Alumni duke i angazhuar në aktivitetet e organizuara nga universiteti dhe duke thithur mendimin e tyre dhe të insitucioneve partnere. Shumë prej tyre marrin pjesë në Panairët apo aktivitetet e tjera tematike të cilat organizohet në manyrë periodike në nga IAL. Gjithashtu, në bazë semestrale zhvillohet një rishikim i përmbatjes së lëndëve dhe rezultateve dhe nga Bordi i provimeve i cili përgatit një raport vjetor.</p> <p><i>Shtojca nr. 31, shtojca nr. 58, shtojca 95, shtojca nr. 96, shtojca nr. 72</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se institucioni monitoron periodikisht cilësinë dhe i përdor këto të dhëna për të adresuar problematikat e identifikuar dhe replikuar praktikat e mira.</i></p> <p><i>Institucioni ka parashikuar në aktet e tij të brendshëm për sigurimin e cilësisë, shfrytëzimin e metodologjive të vlerësimit, instrumenteve të matjes dhe vlerësimit për programet e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: Blloku i Ambasadeve, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342371

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>IAL siguron një përfshirje të të gjithë aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm të sigurimit të cilësisë, falë strukturave të ngritura dhe procedurave të zbatuara në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Manualin “Per Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”.</p> <p>KPSC dhe NJSBC si strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor në përmbushjen e detyrave dhe bazohen në përmbushjen e procedurave të sanksionuara në Manualin e Cilësisë. <i>Shtojca nr. 1, raporti PCAQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfutura gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Senati Akademik ka miratuar të gjitha aktet e nevojshme në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion.</p> <p>Specifikisht, KPSC dhe NJSBC ka hartuar rregullore për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë, si edhe njësimin e sigurimit të cilësisë. Gjithashtu institucioni ka miratuar edhe planin e veprimit hartuar nga KPSC dhe NJSBC për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Brodi i Akreditimit për çdo program studimi.</p> <p><i>Shtojca nr. 44, shtojca nr. 43, shtojca nr. 71</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>KPSC dhe NJSBC së bashku me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit janë përgjegjës për çështjet e cilësisë. Pas shqyrtimit të rregullores dhe manualit, GVJ konstaton se, siç u shprehëm edhe më sipër, se ka një përfshirje të strukturuar të aktorëve të jashtëm në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Specifikisht, njësi bazë është përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e të gjithë këtyre formave të monitorimit dhe bën të mundur analizimin e të dhënave të marra dhe përgatitjen e hapave për përmirësimin e</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342372

administrative dhe studentëve e programit të studimit.	problemeve të identifikuara dhe përgjithësimin e praktikave të mira. <i>Shtojca nr. 1, shtojca nr. 44</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>KPSC zgjidhet nga Senati Akademik dhe anëtarët përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe Këshillin Studentor për të mundësuar sigurimin e cilësisë në përputhje me kuadrin ligjor.</p> <p>Anëtarët e këtyre organeve përzgjidhen nga stafi akademik me eksperiencë dhe me integritet për të shmangur çdo lloj pabarazie në trajtimin e studentëve apo pedagogëve.</p> <p><i>Shtojca nr. 1</i></p>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Për të rritur më tej cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, Epoka angazhon edhe partnerët strategjikë të insitucionit apo Alumni përmes zyrës së karrierës në hartimin apo rishikimin e kurrikulave sic theksohet ne statut (<i>neni 35</i>). Kjo bëhet me qëllim që të kuptohen sa më mirë nevojat e tregut të punës dhe sugjerimet e mbledhura të integrohen në kurrikulat mësimore</p> <p><i>Shtojca nr. 9</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka politika të qarta për promovimin dhe sigurimin e cilësisë si dhe përfshirjen e aktorëve të brendshëm të IAL në këtë proces.</i></p> <p><i>IAL përdor disa mjete për monitorimin e cilësisë dhe përfshin:</i></p> <p><i>a) njësitë akademike nëpërmjet monitorimit periodik; b) personelin akademik; c) studentët në nëpërmjet anketave dhe mekanizmave të ankimit në proceset e kontrollit të cilësisë së programit të studimit; d) anketimet e kompanive dhe alumni.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342373

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin në Rregulloren e Institucionit, por edhe në politika specifike për përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta dhe njësi të dedikuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas kërkesave ligjore. Nga vizita u konstatua që raportimi në RVB përputhej me situatën reale. Përgjegjësit bënë vetëvlerësim, zyra e sigurimit të cilësisë kryente sondazhet, të dhënat përpunoheshin dhe problematikat e identifikuara përcilleshin dhe adresoheshin në instancat e përshtatshme.</p> <p><i>Shtojca nr. 78, shtojca nr. 27</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Bazuar në analizën e RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vëren se njësi përgjegjëse për kontrollin e brendshëm të cilësisë kryen dy anketime në vit për të gjitha lëndët në të dy semestrat e vitit akademik. Anketimet zhvillohen në fund të semestrit përpara se studenti të marrë notën. Të gjithë studentët që janë të pranishëm në klasë marrin pjesë në anketim rezultatet e të cilit përpunohen nga zyra e sigurimit të cilësisë. Të dhënat përfshihen në një raport vjetor i cili nuk përmend emra por identifikon tematika të rëndësishme të cilat më pas bëhen pjesë a planit të punës për njësitë bazë dhe të njësisë së kontrollit të brendshëm të cilësisë. <i>Shtojca nr. 59</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Vlerësimet e kryera dhe rezultatet përkatëse për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit dhe shoqërohen me një plan veprimi. Duke u nisur nga ky plan veprimi dhe bazuar në një kalendar të brendshëm, NjsBC përgatit plan-veprimin, i cili miratohet nga Senati Akademik së bashku me projekt-buxhetin përkatës duke përfshirë nevojat për përmirësimet akademike dhe aktivitetet e departamentëve që synojnë rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të cilësisë akademike. <i>Shtojca nr. 71</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së</p>	<p>Harmonizimi i strukturave të ndryshme të institucionit me KPSC dhe NjsBC siguron koherencë dhe gjithëpërfshirje në drejtim të sigurimit të cilësisë falë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së informacionit duke hartuar sugjerimet dhe përmirësimet përkatëse. KPSC dhe NjsBC hartojnë një raport vjetor ku përfshihen veprimtarinë që këto struktura kanë realizuar për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet e</p>

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342374

programit të studimit.	programeve mësimore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. <i>Shtojca nr. 95</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për të përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies IAL zbaton aktivitete të ndryshme si bashkëbisedime me studentët dhe stafin, thithjen e mendimeve nëpërmjet anketave me studentë, pedagogë, alumni, kompanitë partnere, vizitat e ekspertëve të huaj akademikë dhe jo-akademikë, organizimi i vizitave studimore dhe kërkimore në terren, si edhe trainime për të kërkuar metodologjitë për të përmirësuar programet dhe infrastrukturën në dispozicion për të qenë sa më pranë nevojave të studentëve. <i>Shtojca nr. 78, Shtojca nr. 18</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni zhvillon procese dhe veprimtari të cilat janë publike dhe në tërësi efektive për krijimin dhe institucionalizimin e një kulture cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm të programit të studimit.</i> <i>Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të Universiteti Epoka, janë transparente dhe mundësojnë parimisht akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo subjekt tjetër i interesuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342375

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni disponon një sistem të qëndrueshëm planifikimi dhe menaxhimi financiar, i cili garanton mbështetjen e nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor dhe mbarëvajtjen e programit të studimit;
2. Financimi i burimeve njerëzore, infrastrukturës, teknologjive mbështetëse dhe bibliotekës është i rregullt, i dokumentuar dhe i qëndrueshëm, duke siguruar vazhdimësinë e procesit akademik;
3. Ekzistojnë mekanizma transparentë raportimi dhe auditimi financiar, si dhe mundësi për diversifikimin e burimeve të financimit përmes projekteve dhe granteve;
4. Institucioni ka ndërtuar një strukturë të qartë organizative në nivel institucioni dhe departamenti, e cila mbështet hartimin, zbatimin dhe përditësimin e kurrikulës së programit të studimit, në përputhje me misionin, objektivat dhe standardet e arsimit të lartë;
5. Programi i studimit mbështetet nga një kurrikulë e strukturuar dhe koherente, e cila realizohet nga staf akademik i kualifikuar dhe financohet në mënyrë të qëndrueshme, duke garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor-kërkimor;
6. Ekzistojnë mekanizma funksionale të planifikimit akademik, menaxhimit financiar dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, të cilët mbështesin realizimin e kurrikulës, shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe monitorimin e performancës së programit dhe departamentit;

b. Pika të dobta:

1. GVJ evidenton se ekziston potencial i mëtjshëm për forcimin e formalizimit të mënyrës se si sugjerimet nga rrjetet profesionale dhe shoqatat përkatëse pasqyrohen në syllabus-et dhe programin mësimor. Në vijimësi, IAL-ja mund të ndërmarrë hapa shtesë për dokumentimin sistematik të këtij bashkëpunimi, duke e shndërruar atë në një praktikë të konsoliduar që do të kontribuojë në pasurimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe rritjen e lidhjes me tregun e punës; *(standarti II.5, kriteri 3)*
2. Konstatohet se pjesa më e madhe e titullarëve të lëndëve janë aktualisht të kategorisë “Lektor” me gradë shkencore “Doktor”, gjithashtu, për disa lëndë, si p.sh. gjuhët e huaja, ka raste ku titullari i lëndës është i kategorisë “Asistent Lektor” me gradë “Master Shkencor (MSc)”; *(standarti IV.1, kriteri 1)*
3. Konstatohet se stafi akademik me kohë të plotë i angazhuar në këtë program studimi ka një numër më të lartë lëndësh semestrale në disa raste sesa parashikon Udhëzimi nr. 29/2018; *(standarti IV.1, kriteri 2)*

Rekomandime

1. Rekomandohet që institucioni të harmonizojë formatin e syllabus-eve me kërkesat ligjore në fuqi, me qëllim përmirësimin e përputhshmërisë formale dhe standardizimit të dokumentacionit akademik; *(standarti II.3, kriteri 4)*

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 222-4342376

2. Rekomandohet përfshirja e sugjerimeve, rrjeteve profesionale dhe alumnëve për institucionalizim më të strukturuar të këtij feedback-u për të shtuar ndikimin e tij në zhvillimin e vazhdueshëm të kurikulës; *(standarti II.5, kriteri 3)*
3. Rekomandohet që Institucioni të marrë masa për të mundësuar si titullarë lëndësh në këtë program studimi personel akademik të kategorisë “Profesor”, sipas pika 3 neni 59, Ligjit Nr. 80/2015; *(standarti IV.1, kriteri 1)*
4. Rekomandohet një shpërndarje më e mirë e ngarkesës mësimore në stafin akademik, në mënyrë që të vijojë procesi i përmirësimeve të ndërmarra deri më tani dhe të sigurohet zbatimi i plotë i akteve nënligjore në fuqi; *(standarti IV.1, kriteri 2)*
5. Rekomandohet që njësia bazë në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës të analizojnë arsyet e numrave të ulët të regjistrimeve dhe të bëjë një plan pune për rritjen e regjistrimeve; *(standarti V.4, kriteri 5)*

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342377



Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Political Science and International Relation"

a. Strengths and affirmations:

1. The institution has a sustainable financial planning and management system, which ensures the necessary support for the implementation of the teaching and research process and the proper functioning of the study programme;
2. Funding for human resources, infrastructure, supporting technologies, and the library is regular, documented, and sustainable, ensuring continuity of the academic process;
3. Transparent financial reporting and auditing mechanisms are in place, along with opportunities to diversify funding sources through projects and grants;
4. The institution has established a clear organizational structure at both institutional and departmental levels, which supports the design, implementation, and continuous updating of the study programme curriculum, in line with the mission, objectives, and higher education standards;
5. The study programme is supported by a structured and coherent curriculum, delivered by qualified academic staff and financed in a sustainable manner, ensuring the proper conduct of the teaching and research process;
6. Functional mechanisms for academic planning, financial management, and internal quality assurance are in place, supporting curriculum implementation, teaching workload distribution, and monitoring of programme and departmental performance;

b. Weaknesses:


1. The GVJ notes that there is further potential to strengthen the formalization of how suggestions from professional networks and relevant associations are reflected in the syllabi and the study programme. Going forward, the HEI may take additional steps to systematically document this cooperation, transforming it into a consolidated practice that would contribute to the continuous enrichment of study programmes and the strengthening of their links with the labour market; *(Standard II.5, Criterion 3)*
2. It is observed that the majority of course coordinators currently belong to the category of "Lecturer" with a doctoral degree. Additionally, for some courses, such as foreign languages, there are cases where the course coordinator belongs to the category "Assistant Lecturer" with a "Master of Science (MSc)" degree; *(Standard IV.1, Criterion 1)*
3. It is noted that full-time academic staff engaged in this study programme, in some cases, teach a higher number of semester courses than foreseen by Instruction No. 29/2018; *(Standard IV.1, Criterion 2)*

Recommendation


Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-4342378



1. It is recommended that the institution harmonize the format of syllabuses with applicable legal requirements, in order to improve formal compliance and standardization of academic documentation; *(Standard II.3, Criterion 4)*
2. It is recommended to include feedback from professional networks and alumni through a more structured institutionalization of this input, in order to enhance its impact on the continuous development of the curriculum; *(Standard II.5, Criterion 3)*
3. It is recommended that the institution take measures to enable academic staff of the “Professor” category to serve as course coordinators in this study programme, in accordance with Article 59, paragraph 3 of Law No. 80/2015; *(Standard IV.1, Criterion 1)*
4. It is recommended to further improve the distribution of teaching workload among academic staff, in order to continue the improvement process undertaken so far and ensure full compliance with the applicable secondary legislation; *(Standard IV.1, Criterion 2)*
5. It is recommended that the basic unit, in cooperation with the Career Office, analyze the reasons for the low enrollment numbers and develop an action plan to increase student enrollment; *(Standard V.4, Criterion 5)*



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTUR, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr. Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1,Tiranë

E-mail: info@ascal.al
Tel:+355 (04) 222-4342380